



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 479 Akti

Nr. 355 Vendimi
Tiranë, më 16.3.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në datën 16.3.2021, ora 09:45, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati i 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Irida Kacerja**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Irida Kacerja është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Znj. Irida Kacerja, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 8.6.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Valbona Sanxhaktari dhe Etleda Çiftja.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 8.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Valbona Sanxhaktari. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 17.6.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni gjithashtu i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.
6. Trupi gjykues, me vendimin datë 21.10.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e

¹ E-mail datë 17.6.2020, ora 11:26 “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

7. Në datën 22.10.2020, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 18.12.2020; dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjekti iu kërkuua të paraqiste prova dhe shpjegime brenda datës 29.10.2020.

8. Në datën 28.10.2020 subjekti paraqiti me anë të postës elektronike³ dhe pranë Komisionit pretendimet e saj me shkrim dhe dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Më tej, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike⁴ se trupi gjykues, me vendimin e datës 11.11.2020, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 20.11.2020, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

10. Në datën 18.11.2020 Komisioni administroi dy denoncime nga publiku në lidhje me subjektin e rivlerësimit, znj. Irida Kacerja. Nga analizimi i këtyre denoncimeve, trupi gjykues vendosi në datën 18.11.2020 riçeljen e hetimit administrativ për verifikimin e fakteve dhe dokumentacionit të administruar nga denoncuesit.

11. Në datën 19.11.2020, nëpërmjet postës elektronike⁵, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi vendimin e po kësaj date të trupit gjykues, për shtyrjen e seancës dëgjimore të planifikuar më 20.11.2020, ora 10:00, dhe riçeljen e hetimit administrativ kryesisht, bazuar në dy denoncime që janë administruar në datën 18 në Komision. Gjithashtu, subjektit iu bë me dije se sapo të mbarojë hetimi për faktet e pasqyruara në këto denoncime, do t'i vihen në dispozicion rezultatet e këtij hetimit dhe do të ketë të drejtën e paraqitjes së prapësimeve.

12. Pasi kreu hetimin mbi këto denoncime dhe *indicie*-t e marra prej tyre, trupi gjykues vendosi përfundimin e hetimit kryesisht shtesë në datën 24.2.2021, dhe përmes postës elektronike⁶ njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht shtesë; (ii) të drejtën për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; dhe (iii) të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet shtesë të hetimit.

13. Në datën 5.3.2021, me anë të postës elektronike⁷, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe provat për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht shtesë.

14. Më tej, me vendimin datë 8.3.2021, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe Kodin e Procedurave Administrative, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e

² E-mail datë 22.10.2020, ora 11:34 "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

³ E-mail datë 28.10.2020, ora 21:52 "FW: Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

⁴ E-mail datë 11.11.2020, ora 10:08 "Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore".

⁵ E-mail datë 19.11.2020, ora 14:18 "Njoftim për shtyrje të seancës dëgjimore".

⁶ E-mail datë 24.02.2021, ora 12:32 "Njoftim mbi përfundimin e rezultateve shtesë të hetimit".

⁷ E-mail datë 5.3.2021, ora 11:32 "Re: Njoftim mbi përfundimin e rezultateve shtesë të hetimit".

hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 10.3.2021, ora 10:00.

15. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Në datën 10.3.2021 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

17. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

18. Znj. Irida Kacerja, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

19. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

20. Seanca dëgjimore e datës 10.3.2021 u ndërpre, për të rifilluar në datën 16.3.2021, për shpalljen e vendimit.

21. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 10.3.2021, subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

22. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

23. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

24. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

25. Referuar vendimit nr. 2/2017⁸, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

26. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2007, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

27. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2007 - 2016 dhe në datën 20.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

28. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, për vitet 2003 - 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

29. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii)

⁸ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

30. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon:

30.1 Z. M.B., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur.

30.2 Znj. E.K. – konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i dhënies në përdorim pa kundërshtëpërbllim të apartamentit me sip. 55.1 m², ndodhur në lagjen “****”, Tiranë, për periudhën mars 2014 – qershor 2016.

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Llogari rrjedhëse në vlerën 215.857 lekë, në “Raiffesen Bank” sh.a.

1.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse e krijuar në vite në ‘Raiffeisen Bank’ sh.a. (me kontratat datë 30.9.2011, datë 24.1.2012 dhe datë 30.7.2012). Vlera: 215.857 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara nga puna si gjyqtare”. Për vërtetimin e deklarimeve të saj ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁹.

1.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”¹⁰ konfirmohet llogari rrjedhëse në emër të subjektit të rivlerësimit dhe ligjshmëria e fondeve të derdhura në këtë llogari.

1.3. Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këtë llogari rrjedhëse nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

1.4. Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe ka burime të ligjshme me dokumentacion justifikues për krijimin e saj.

2. Kuota në vlerën 10.000 euro, në fondin e investimit “Raiffeisen Invest” sh.a.

2.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Të ardhura të krijuara nga blerja e kuotave në Fondin e Investimit ‘Raiffeisen Invest Euro’, kontratë e datës 25.3.2016 e nënshkruar nga bashkëshorti M.B. Investim në vlerën 10.000 euro – interesa të përfituara deri më 18.1.2017, në shumën 234 euro. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara nga puna si gjyqtare dhe ndihmësligjore dhe e bashkëshortit si avokat”. Për vërtetimin e deklarimeve të saj subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹¹.

⁹ Nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 27.10.2016, për depozitë me gjendje më 30.9.2016, në vlerën 215.857 lekë; konfirmim bankar nga “Raiffeisen Bank”, datë 16.1.2017, për depozitë me gjendje më 16.1.2017, në vlerën 215.684 lekë.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 2.7.2020.

¹¹ Vërtetim nr. ***, datë 17.1.2017, mbi pasqyrën e llogarisë në “Raiffeisen Invest”, i shtetasit M.B., totali i blerjeve: 10.000 euro. Vlera totale e kuotave: 10.234 euro; kontratë llogari rrjedhëse datë 25.3.2016, e lidhur midis z. M.B. dhe “Raiffeisen Bank” sh.a., urdhër për blerjen e kuotave në “Raiffeisen Invest”, datë 25.3.2016. Investitor: M.B. Vlera: 10.000 euro; mandatarkëtimi në “Raiffeisen Bank”, datë 25.3.2016, përfitues M.B. Vlera: 10.000 euro; kërkesë për transferim fondesh në “Raiffeisen Direkt”, datë 25.3.2016. Urdhërues: M.B. Përfitues: “Raiffeisen Invest”. Vlera: 10.000 euro.

2.2 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Invest”¹² konfirmohet se personi i lidhur/M.B. ka marrëdhënie juridike me këtë fond investimi dhe ka investuar në fondin në euro me gjendje 11.564,91 euro deri në datën 18.6.2020.

2.3 Në dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank”¹³ evidentohet depozitimi në shumën 10.000 euro në datën 25.3.2016, nga z. M.B. në llogarinë e tij rrjedhëse, dhe më tej, në të njëjtën datë, pasqyrohet kalimi i kësaj shume në fondin “Raiffeisen Invest”.

Lidhur me analizën financiare për burimin e krijimit të shumës 10.000 euro të investuar në “Raiffeisen Invest”

2.4 Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se për vitin 2007, kur ka filluar punë për herë të parë (në datën 5.10.2007), ka jetuar me prindërit dhe motrën e saj. Subjekti ka shpjeguar se gjatë kësaj periudhe shpenzimet e jetesës i ka paguar gjithë familja, sipas mundësisë dhe nevojave. Nga data 26.8.2008 motra e subjektit është larguar për në K., Norvegji, për studime dhe aktualisht jeton në B., Norvegji. Më tej, subjekti deklaroi se nga marsi i vitit 2014 ka bashkëjetuar me bashkëshortin (me të cilin vazhdon të jetojë edhe aktualisht, së bashku me vajzën e tyre) dhe shpenzimet e jetesës janë përballuar prej të dyve. Që nga martesa, subjekti shpjegon se ka jetuar me periudha të shkurtra në banesën e ndodhur në D., Shkodër, Njësia Administrative ***, në bashkëpronësi të bashkëshortit, nënës dhe motrave të tij. Në këtë banesë ka jetuar me bashkëshortin dhe duke qenë në bashkëpronësi të tij, nuk kanë paguar qira dhe kanë qenë me ekonomi të ndarë nga vjehrra.

2.5 Për sa i përket burimit të vlerës së investuar në shumën 10.000 euro në fondin “Raiffeisen Invest”, në pyetësin nr. 2 subjekti ka shpjeguar se totali prej 1.400.000 lekësh i kursyer në gjendjen *cash*, që disponohej në banesë në datën 31.12.2015, është përdorur për krijimin e llogarisë në “Raiffeisen Invest” më 25.3.2016.

2.6 Për sa më sipër, për efekt të analizës financiare për periudhën gjatë së cilës janë krijuar kursimet për investimin në “Raiffeisen Invest”, Komisioni kreu analizat financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, si në vijim: (a) analiza financiare për periudhën 2007 – 2013, për subjektin e rivlerësimit dhe prindërit¹⁴; (b) analiza financiare për periudhën 2014 – 2015, për subjektin, bashkëshortin dhe vajzën; (c) analiza financiare për periudhën 2004 – 2013, për bashkëshortin, me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm për shumën 1.200.000 lekë, për të cilën në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 janë deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga puna.

a) Analiza financiare për periudhën 2007 – 2013 për subjektin e rivlerësimit dhe prindërit, me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm të kursimeve në vlerën 400.000 lekë në fund të vitit 2015

2.7 Komisioni analizoi deklaratimet e gjendjes së likuiditeteve *cash* në deklaratat periodike vjetore, ku rezultoi se subjekti ka deklaruar si në vijim: (i) në DPV-të e viteve 2007 - 2011 nuk ka deklaruar gjendje, shtesa apo pakësime të gjendjes së likuiditeteve *cash*; (ii) në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar shumën 300.000 lekë “kursime nga paga – *cash*”; (iii) në DPV-në e vitit 2013 ka deklaruar shumën 400.000 lekë “kursime nga paga – *cash*”; (iv) në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar shumën 400.000 lekë “kursime nga paga – *cash*”, ndërsa bashkëshorti

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 23.6.2020.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 2.7.2020.

¹⁴ Motra e subjektit, znj. S.K., referuar sistemit *TIMS* është larguar nga Shqipëria në datën 9.8.2008. Të ardhurat e saj për periudhën janar 2007 – gusht 2008 kanë qenë në shumën 1.015.948 lekë, të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve jetike për një person (265.162 lekë për të njëjtën periudhë).

ka deklaruar shumën 1.200.000 lekë “shuma të kursyera gjatë viteve nga puna të disponuara në *cash*”; (v) në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar shumën 400.000 lekë “kursime nga paga – *cash*”, ndërsa bashkëshorti ka deklaruar shumën 500.000 lekë “shumë e kursyer nga puna e kryer gjatë vitit, e disponuar në *cash*”; dhe (vi) në DPV-në e vitit 2016 nuk ka deklaruar gjendje, shtesa apo pakësime të gjendjes së likuiditeteve *cash*.

2.8 Duke qenë se në deklaratën *Vetting* subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar gjendje të likuiditeteve *cash*, me anë të pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me deklaratimet ndër vite.

2.9 Në përgjigje, subjekti shpjegoi: “[...] Në lidhje me vlerën e likuiditeteve *cash*, çmuj të sqaroj, paraprakisht, se nga ana ime është kuptuar ndryshe mënyra e plotësimit të vlerës së kursimeve *cash* që ndodhen në banesë në momentin e deklaratimit, nga ajo që kenë evidentuar në pyetjen tuaj. Këto kursime *cash* në fakt nuk janë një shumatore e të gjitha deklaratimeve për secilën DPV, por janë shuma progresive që ishin mbartur nga viti paraardhës, me shtimet ose pakësimin e gjendjes *cash*, sipas rastit [...]”.

2.10 Më tej, subjekti ka specifikuar se për sa i përket deklaratimit të kursimeve *cash* në vitin 2015, prej saj është ndjekur metodika e ndjekur më lart, duke deklaruar gjendjen *cash* që dispononte në banesë. Ndërkohë, rubrika e deklaratimit të bashkëshortit është rubrikë më vete dhe siç ka sqaruar ai, deklarimi i shumës 500.000 lekë në DPV-në e vitit 2015 janë kursime të krijuara nga aktiviteti i tij tregtar gjatë vitit 2015, që i dispononte në banesë. Për sa i përket shumës prej 1.200.000 lekësh të deklaruar në DPV-në e vitit 2014, bashkëshorti referon se nga kjo shumë janë shpenzuar 700.000 lekë (rritje e shpenzimeve për shkak të fëmijës së sapolindur), ndërsa shumën e mbetur prej 500.000 lekësh (1.200.000 - 700.000) nuk e ka rideklaruar në DPV-në e vitit 2015, me arsyetimin se ajo është deklaruar një herë në vitin 2014 dhe nuk ishte në dijeni të faktit që duhej të deklarohej dhe pakësimi i saj.

2.11 Si përfundim, subjekti paraqiti në formë tabelare gjendjet e likuiditeteve në fund të vitit për të dhe bashkëshortin, ku evidentohen gjendjet e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti, dhe konkretisht për periudhën 2012 – 2016, deklaroi: (i) në fund të vitit 2012, gjendje *cash* 300.000 lekë – subjekti; (ii) në fund të vitit 2013, gjendje *cash* 400.000 lekë – subjekti; (iii) në fund të vitit 2014, gjendje *cash* 400.000 lekë – subjekti dhe 1.200.000 lekë – bashkëshorti; (iv) në fund të vitit 2015, gjendje *cash* 400.000 lekë – subjekti dhe 1.000.000 lekë – bashkëshorti; (v) në fund të vitit 2016, gjendje *cash* 0 lekë.

2.12 Sa më sipër, referuar deklaratimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore, shpjegimeve në pyetësorin nr. 2 dhe deklaratimit të gjendjes zero të likuiditeteve *cash* në deklaratën *Vetting*, Komisioni vëren se deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore ndër vite lidhur me likuiditetet *cash* kanë të bëjnë me gjendjen e tyre në fund të çdo viti kalendarik. Për sa i përket gjendjes së likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2015, Komisioni, duke iu referuar deklaratimit në deklaratën periodike vjetore, konsideroi shumën 900.000 lekë si gjendje e likuiditeteve *cash* në fund të këtij viti dhe jo shumën 1.400.000 lekë siç deklaroi subjekti në pyetësor.

2.13 Subjekti ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësorin standard dokumentacionin ligjor justifikues lidhur me të ardhurat e përfituara për periudhën 2007 – 2013¹⁵ dhe gjithashtu

¹⁵ Vërtetim page, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të ardhurat e përfituara nga znj. Irida Kacerja për periudhat tetor 2007 – nëntor 2012 dhe nëntor 2015 – dhjetor 2016; vërtetim page nr. *** prot., datë 17.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Lartë, për të ardhurat e përfituara nga znj. Irida Kacerja për periudhën 16.11.2012 – 15.11.2015; vërtetim nr. *** prot., datë 29.3.2013, i lëshuar nga kolegji profesional “A.” Shkodër. Në analizën financiare u konsideruan kreditimet për pagat/bursën në “Raiffeisen Bank” (406.050 lekë), në “Credins Bank” (në shumën 1.217.051 lekë) dhe në “Tirana Bank” (në shumën 4.614.624 lekë) dhe vërtetimi i lëshuar nga kolegji “A.” (në shumën 97.500 lekë).

u konsideruan edhe të ardhura nga bursa dhe si lehtësuese në Shkollën e Magjistraturës¹⁶. Subjekti gjithashtu dorëzoi dokumentacion ligjor justifikues lidhur me të ardhurat e prindërve¹⁷.

2.14 Referuar analizës financiare për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe prindërve për periudhën 2007 – 2013, u konstatuan balanca pozitive në fund të çdo viti kalendarik.

2.15 Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive përgjatë periudhës 2007 – 2013.

b) Analiza financiare për periudhën 2014 – 2015 për subjektin, bashkëshortin dhe vajzën, me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm të shumës së kursyer në fund të vitit 2015, në vlerën 900.000 lekë

2.16 Subjekti ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësorin standard dokumentacionin ligjor justifikues lidhur me të ardhurat e përfituara për periudhën 2014 – 2015¹⁸, si dhe u konsideruan edhe të ardhura si autore tekstesh në Shkollën e Magjistraturës¹⁹. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit si avokat dhe ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues²⁰.

2.17 Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Të ardhura të krijuara nga veprimtaria si avokat (Person Fizik), anëtar i Dhomës së Avokatisë, Shkodër, nga data e martësës, mars i vitit 2014, deri në dorëzimin e deklaratës së pasurisë – xhiro (duke zbritur TVSH-në) e deklaruar pranë organeve tatimore. Shuma: 2.740.060 lekë, nga të cilat shuma prej 652.000 lekësh nuk është likuiduar ende nga klientët, por sipas detyrimeve ligjore është deklaruar nga ana ime dhe është paguar vlera e TVSH-së. Në këto të ardhura nuk janë zbritur pagesat për efekt të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe taksat vendore që në total janë në vlerën 217.845 lekë*”.

2.18 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Të ardhura të fituara nga veprimtaria private si avokat (Person Fizik), shuma 40.000 lekë*”.

¹⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 22.6.2020, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, në përgjigje të kërkesës së Komisionit.

¹⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, lëshuar nga ISSH Shkodër, për pensionin e invaliditetit të përfutur nga z. Y.K., për periudhën 29.4.2008 – 31.10.2016; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* lëshuar nga ISSH Shkodër për z. S.K., për periudhën 1.1.2007 – 2.7.2008; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* lëshuar nga ISSH Shkodër për z. S.K., për periudhën 4.3.2010 – 30.4.2010; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* lëshuar nga ISSH Shkodër për z. S.K., për periudhën 20.3.2011 – 30.9.2011; vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, lëshuar nga ISSH Shkodër, për pensionin e përfutur nga z. S.K., për periudhën 10.1.2012 – 31.10.2016; vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, lëshuar nga ISSH Shkodër, për kontributet e derdhura nga “M.”, për z. S.K., për periudhën mars – nëntor 2011; vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, lëshuar nga ISSH Shkodër, për kontributet e derdhura nga “P.”, për z. S.K., për periudhën mars – prill 2014, në total 1.611.585 lekë.

¹⁸ Vërtetim page, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të ardhurat e përfituara nga znj. Irida Kacerja për periudhën tetor 2007 – nëntor 2012 dhe nëntor 2015 – dhjetor 2016; vërtetim page nr. *** prot., datë 17.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Lartë, për të ardhurat e përfituara nga znj. Irida Kacerja për periudhën 16.11.2012 – 15.11.2015; vërtetim datë 17.10.2016, lëshuar nga H.S.S. dhe marrëveshje honorari ku specifikohet ndalesa e tatimit në burim. Në analizën financiare u konsideruar kreditimet për pagat/përfitimet nga ISSH-ja: në “Credins Bank” (në shumën 2.213.718 lekë) dhe vërtetimi i lëshuar nga Fondacioni S.S. (në shumën 189.149 lekë).

¹⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 22.6.2020, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, në përgjigje të kërkesës së Komisionit.

²⁰ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.11.2016, nga DRT-ja Shkodër; për z. M.B.; nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, për transaksionet e kryera në llogarinë e personit fizik “M.B.”, për periudhën 2014 – 2016; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* për z. M.B. si Person Fizik, lëshuar nga ISSH-ja Shkodër, për periudhën 1.7.2011 – 31.12.2012.

2.19 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Të ardhura të fituara nga veprimtaria private si avokat (Person Fizik), shuma 1.422.334 lekë*”.

2.20 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Të ardhura të fituara nga veprimtaria private si avokat (Person Fizik) – xhiro duke zbritur TVSH-në e deklaruar pranë organeve tatimore në shumën 1.130.446 lekë, nga të cilat shuma prej 555.000 lekësh nuk është likuiduar ende nga klientët, por sipas detyrimeve ligjore është deklaruar nga ana ime dhe është paguar vlera e TVSH-së. Në këto të ardhura nuk janë zbritur pagesat për efekt të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe taksat vendore që në total janë në vlerën 127.137 lekë*”.

2.21 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve²¹ ka vënë në dispozicion deklaratat vjetore të deklarimit të tatim-fitimit të thjeshtuar, nga ku rezulton se për periudhën 2014 – 2016 totali i të ardhurave ka qenë në shumën 2.740.060 lekë, totali i shpenzimeve ka qenë në shumën 217.845 lekë dhe totali i fitimit ka qenë në shumën 2.522.215 lekë, të detajuar për çdo vit kalendarik, si vijon: (i) për vitin 2014 të ardhurat kanë qenë 40.000 lekë, shpenzimet 0 (zero) lekë, fitimi 40.000 lekë dhe tatimi fiks 25.000 lekë; (ii) për vitin 2015 të ardhurat kanë qenë 1.569.612 lekë, shpenzimet 90.672 lekë, fitimi 1.478.940 lekë dhe tatimi fiks 25.000 lekë; (iii) për vitin 2016 të ardhurat kanë qenë 1.130.448 lekë, shpenzimet 127.173 lekë, fitimi 1.003.275 lekë dhe tatimi fiks 0 (zero) lekë.

2.22 Në lidhje me pasqyrimin e fitimit *neto* nga aktiviteti në analizën financiare, Komisioni mori në konsideratë: (i) deklarimin e subjektit në pyetësin nr. 2 në lidhje me likuidimin e mëvonshëm të disa faturave, ku konstatohet se fatura nr. ***, datë 28.7.2015, me vlerë 120.000 lekë është likuiduar në datën 3.7.2018; (ii) shumën e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2014²², evidentuar në shkresën e DPT-së (17.439 lekë); (iii) tatimin fiks të vitit 2014, që paguhet vitin pasardhës (25.000 lekë); (iv) tatimin fiks të vitit 2015, që paguhet vitin pasardhës (25.000 lekë); (v) pasqyrat financiare të vitit 2016, ku evidentohet shuma e klientëve të paarkëtuar (772.000 lekë), të drejta të tjera (85.773 lekë) dhe detyrime të tjera (26.556 lekë).

2.23 Sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2014 – 2015, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve, blerjen e pasurive dhe shtesën e kursimeve përgjatë periudhës 2014 – 2015.

c) Analiza financiare për bashkëshortin për periudhën 2004 – 2013, me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm të kursimeve në vlerën 1.200.000 lekë (deklaruar në vitin 2014)

2.24 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues²³ lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nga punësimi. Më tej, në pyetësin standard, subjekti ka dorëzuar dokumentacion shtesë²⁴ lidhur me të ardhurat e bashkëshortit përpara vitit 2013.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2020.

²² Evidentuar në shkresën e DPT-së, në dokumentin me emërtim “ekstrakti historik i punonjësit”.

²³ Nxjerrje llogarie nga ISP Bank për z. M.B.; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.11.2016, nga DRT-ja Shkodër për z. M.B., tatimpaguesi me NIPT ***, vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* për z. M.B. si Person Fizik, lëshuar nga ISSH Shkodër për periudhën 1.7.2011 – 31.12.2012, në shumën 270.360 lekë.

²⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 15.6.2020, lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Shkodër; librezat e kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore me nr. serie ***, nr. sigurimi ***, ku vërtetohet pagesa e kontributeve nga subjekti Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Shkodër dhe subjekti “D.” sh.p.k. për periudhën korrik 2007 – janar 2008, si dhe nga subjekti SHIS, shoqata ***, për periudhën shkurt 2008 – shkurt 2011; kontratë pune e lidhur mes z. M.B. dhe “D.” sh.p.k., në datën 1.7.2007; autorizim datë 21.6.2001, lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Tiranë, ku vërtetohet se me vendimin nr. ***, datë

2.25 Komisioni hetoi mbi këto të ardhura, duke i drejtuar shkresë Kryqit të Kuq Shqiptar, dega Shkodër, i cili në përgjigjen e tij²⁵ vendosi në dispozicion dokumentacion justifikues²⁶. Gjithashtu, Komisioni iu drejtua edhe drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, e cila në përgjigje të saj²⁷ konfirmoi periudhat kontributive, shkurt 2008 – mars 2011 nga Shoqëria *** për shtetasin M.B.

2.26 Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e shtetasit M.B. për periudhën nëntor 2004 – 2013, nga ku rezultoi një balancë pozitive.

2.27 Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet dhe provat e sipërpërmendura, rezultoi se personi i lidhur/M.B. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe kursimin e shumës 1.200.000 lekë deri në fund të vitit 2013.

2.28 Në vijim të analizës së mësipërme, bazuar në deklarin e subjektit në deklaratën *Vetting* për sa i përket burimit të krijimit të shumës 10.000 euro, Komisioni mori në analizë edhe periudhën 1.1.2016 – 25.3.2016 (data e depozitimit në llogarinë bankare), nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 231.469 lekë.

2.29 Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, subjektit iu kaluar barra e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova në lidhje me konstatimin se: subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, me një balancë negative në shumën 231.469 lekë.

2.30 Në prapësimet e subjektit për sa i përket gjendjes së likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2015 të përlogaritur nga Komisioni në vlerën 900.000 lekë përkundrajt vlerës 1.400.000 lekë të pretenduar prej saj, subjekti paraqiti të njëjtin shpjegim si në pyetësonin nr. 2 (paragrafi 2.12 i relacionit) lidhur me mënyrën e deklarin të likuiditeteve nga bashkëshorti, duke theksuar se totali prej 1.400.000 lekësh i kursyer në gjendjen *cash* që disponohej në banesë në datën 31.12.2015 është përdorur për krijimin e llogarisë në “Raiffeisen Invest” më 25.3.2016.

2.30.1 Më tej, subjekti ka analizuar mundësitë e bashkëshortit për krijimin e kursimeve në shumën 500.000 lekë të deklaruara në DPV-në e vitit 2015, duke u ndalur në balancën pozitive të vitit 2015, duke shpjeguar se: “[...] rezulton se nga diferenca mes totalit të të ardhurave të ligjshme të krijuara nga ana ime dhe bashkëshorti gjatë vitit 2015 dhe totalit të shpenzimeve, do kemi një rezultat ‘potencial kursimi’ për këtë vit, në masën 1.419.581 lekë [...]”.

2.30.2 Më tej, subjekti u ndal në tërheqjet e kryera nga bashkëshorti gjatë vitit 2015, duke evidentuar se gjatë këtij viti ka tërhequr nga llogaria e tij në “Credins Bank” shumën 1.113.204 lekë, përkatësisht 353.000 lekë dhe 5.530 euro dhe shpjegoi se: “Në DPV-në e vitit 2015, në rubrikën ku janë pasqyruar kursimet e bashkëshortit tim, përcaktohet në mënyrë shteruese se vlera 500.000 lekë janë kursime *cash* të krijuara nga puna si avokat vetëm për vitin 2015 dhe nuk është pasqyruar ndryshimi i likuiditetit *cash* të vitit paraardhës”.

2.30.3 Në vijim, subjekti paraqiti një analizë mbi potencialin e gjendjes *cash* për vitin 2015, duke mbledhur atë për kursim në vitin 2015 në shumën 1.419.581 lekë me shumën e

21.6.2001, KQZ-ja ka miratuar kërkesën e INSIZ-it për të pasur vëzhgues në qendër votimi shtetasin M.B.; kontratë shërbimi datë 20.12.2004, mes *OSCE Presence in Albania* dhe z. M.B. (ne cilësinë e ekspertit); lëvizje e llogarisë me nr. ***, në “ProCredit Bank”.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2020.

²⁶ Pasqyrë përmbledhëse e të ardhurave të z. M.B. për periudhën nëntor 2004 – dhjetor 2009, formularë pagesash për punonjësin, listëpagesa, duke saktësuar se për muajt tetor dhe dhjetor të vitit 2015 nuk është arritur të gjenden dokumentet për lëvizjet monetare.

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2020.

likuiditeteve *cash* të deklaruar në vitin 2014, pra, 1.600.000 lekë, dhe duke i zbritur kësaj shume gjendjen e likuiditeteve *cash* prej 900.000 lekësh të përlogarit nga Komisioni, me një rezultat të totalit të shpenzuar nga potenciali i gjendjes *cash* në shumën 2.119.581 lekë.

2.30.4 Lidhur me këtë situatë, subjekti sqaroi se: *“Duke marrë në konsideratë konstatimet e Komisionit që kursimi cash në datën 1.1.2016 që disponohej nga ana ime dhe e bashkëshortit ishin në vlerën 900.000 lekë, ndryshe nga ajo e sqaruar nga ana ime në pyetësin nr. 2 (që është në masën 1.400.000 lekë), do krijonte një situatë hipotetike, ku shpenzimet e vitit 2015 do të ishin në mënyrë të shpërpjesëtuar dhe që nuk përputhet me nivelin e shpenzimeve dhe stilin e jetës që ndiqja, përpara dhe pas vitit 2015. Pra, nëse do merret i mirëqenë përfundimi i Komisionit që gjendja cash në datën 31.12.2015 është në masën 900.000 lekë, kjo do të çonte në përfundimin që shpenzimet potenciale të vitit 2015 do të ishin në vlerën 2.119.581 lekë, përtej shpenzimeve të përlogaritura nga Komisioni në analizën financiare. Ky fakt nuk ka ndodhur, sepse nëse do ishte i tillë do ishte përkthyer/reflektuar në rritjen e likuiditetit në bankë, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme. Siç dhe ju e keni konstatuar në analizën financiare të kryer, shpenzimet e mia për të gjithë periudhën e deklarimit në vite kanë qenë të kufizuara me të ardhura që rrjedhin nga i njëjti burim dhe ky stil jetese është ruajtur dhe në vitin 2015. E ritheksoj se diferenca e krijuar mes likuiditetit cash për vitin 2015 nga deklarimi im në pyetësin nr. 2 dhe përfundimit të Komisionit në relacion ka ardhur nga mos pasqyrimi nga ana e bashkëshortit të pakësimit të gjendjes cash të deklaruar në DPV-në e viteve 2014 dhe 2015, si rezultat i mungesës së eksperiencës nga ana e tij në plotësimin e deklaratës së pasurisë. Pra deklarimi ynë nuk ka asnjë synim për të pasqyruar të dhëna të pavërteta apo fshehur pasuri të paligjshme”.*

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

2.31 Komisioni thekson se mbështetur në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur detyrimin të deklaronin çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes së kursimeve *cash*, nëse kjo kishte ndodhur në vitin përkatës. Në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin “ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, kërkohet nga deklaruesit: *“Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: [...] të çdolloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit”.*

2.32 Pavarësisht mundësisë potenciale për kursim²⁸, për sa kohë shumat e kursyera nuk janë deklaruar në deklaratën periodike përkatëse, nuk mund të merren në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare. Për këto arsye, në konkluzion të shqyrtimit të këtij pretendimi, Komisioni vlerëson se nuk është bindës dhe, për pasojë, nuk mund të merret në konsideratë.

2.33 Në vijim të shpjegimeve të subjektit se si burim për krijimin e shumës 10.000 euro kanë shërbyer vetëm likuiditetet *cash* në fund të vitit 2015, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 484.900 lekë (diferenca e ekuivalentit prej 1.384.900 lekësh të shumës 10.000 euro me gjendjen e likuiditeteve *cash* prej 900.000 lekë në fund të vitit 2015).

2.34 Në përfundim të analizimit të burimit të ligjshëm për krijimin e blerjeve të kuotave me vlerë 10.000 euro në Fondin e Investimit “Raiffeisen Invest” sh.a., rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme shoqëruar me

²⁸ Në analizën e potencialit për kursim për vitin 2015, subjekti nuk merr në konsideratë në analizën e kryer shtesën e gjendjes së llogarive bankare në shumën 220.456 lekë.

dokumentacion justifikues për blerjen e këtyre kuotave në vlerën monetare 10.000 euro, në shumën 484.900 lekë.

3. Banesë me qira në lagjen “**”, Tiranë**

3.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Banesë në përdorim (qira) me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, e ndodhur në rrugën ‘****’, lagjja ‘****’, Tiranë, e cila është në pronësi të znj. E.K. Kontratë qiraje me shkresë të thjeshtë e datës 1.7.2016, qiraja mujore në shumën 28.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %*”. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁹.

3.2 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DPV-në e viteve 2016 dhe 2017 subjekti ka deklaruar: “*Banesë në përdorim (qira) me sip. 55.1 m², me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, e ndodhur në rrugën ‘****’, lagjja ‘****’, Tiranë, e cila është në pronësi të znj. E.K. Kontratë qiraje me shkresë të thjeshtë e datës 1.7.2016, qiraja mujore në shumën 14.000 lekë*”.

3.3 Referuar dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, rezulton se në datën 1.7.2016 subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës qiramarrëse, dhe shtetasja E.K., në cilësinë e palës qiradhënëse, kanë lidhur një kontratë të thjeshtë qiraje për apartamentin me sip. 55.1 m², me nr. pasurie ****, me adresë: lagjja “****” Tiranë. Qiraja mujore është në vlerën 14.000 lekë/muaj. Në momentin e nënshkrimit të kontratës qiramarrësi do t’i paguajë qiradhënësit shumën 28.000 lekë, e cila përfaqëson pagesën e qirasë për dy muajt e parë. Qiradhënësjja është përfaqësuar nga i vëllai, z. A.H., i cili me prokurën e posaçme nr. ****, datë 9.8.2012, autorizohet të kryejë të gjitha veprimet për blerjen e apartamentit të porositur me kontratë porosie, shitjen e tij, si dhe çdo veprim tjetër, veprime të cilat do të konsiderohen të drejta dhe të mirëqena nga pronarja e apartamentit.

3.4 Me anë të pyetësorit nr. 1³⁰ Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasi në deklaratën *Vetting* është deklaruar qiraja mujore në vlerën 28.000 lekë, ndërkohë që në kontratë vlera mujore është 14.000 lekë. Në përgjigje³¹ të saj subjekti deklaroi se shuma prej 28.000 lekësh është një gabim material i ardhur nga fakti se në kontratën e qirasë është parashikuar parapagimi i shumës 28.000 lekë, që përfaqëson vlerën e 2 muajve të parë të qirasë. Vlera mujore e qirasë është 14.000 lekë, siç rezulton nga kontrata e qirasë.

3.5 Më tej, Komisioni vëren se edhe në kontratë parashikohet se data e fillimit të kontratës është 1.7.2015 (pra, një vit përpara datës së lidhjes së kontratës) dhe kohëzgjatja do të jetë për një periudhë deri më 1.7.2017, ndërkohë që subjekti në pyetësorin standard ka deklaruar: “[...] vlera e kësaj qiraje me kontratën e datës 1.7.2016, e cila kishte afat 1-vjeçar [...]”. Për këtë arsye, subjektit iu kërkuar shpjegime me anë të pyetësorit nr. 3, e cila në përgjigjen e saj shpjegoi se është vetëm një gabim material.

3.6 Bashkëlidhur kontratës së qirasë, gjendet aneksi nr. 1, sipas të cilit qiradhënësjja E.K. (përfaqësuar nga z. A.H.), ka deklaruar se: “*Qiramarrësi e ka përdorur për qëllime banimi apartamentin objekt të kësaj kontrate duke filluar nga data 1.3.2014, pa pagesë, kundrejt detyrimit për t’u përkujdesur në mirëmbajtjen e zakonshme të pasurisë dhe pagesën e faturave të energjisë elektrike dhe të ujit. Një marrëveshje e tillë ka ardhur për shkak të miqësisë*

²⁹ Kontratë qiraje datë 1.7.2016, qiraja mujore 14.000 lekë/muaj; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 8.1.2014, për apartamentin me sip. 55.1 m², me nr. pasurie ****, regjistruar në emër të znj. E.K.; kartela e pasurisë, prokurë e posaçme nr. ****, datë 9.8.2012.

³⁰ E-mail datë 15.9.2020, ora 15:30.

³¹ E-mail datë 20.9.2020, ora 21:11.

familjare që ekziston mes qiradhënësës dhe qiramarrësës. Qiradhënësja banon në Itali dhe apartamenti ishte i pashfrytëzuar. Detyrimi që lind nga kontrata e qirasë bëhet duke marrë në konsideratë periudhën e gjatë të përdorimit të apartamentit nga qiramarrësja dhe duke marrë në konsideratë që fillimisht ishte parashikuar që përdorimi pa pagesë do bëhet përkohësisht”.

3.7 Referuar certifikatës së pronësie nr. ***, datë 8.1.2014, dhe kartelës së pasurisë datë 8.1.2014, ky apartament figuron i regjistruar në emër të shtetasës E.K.

3.8 Në pyetësin standard, subjekti deklaron se nga data 1 mars e vitit 2014 ka jetuar në këtë apartament dhe shtetasja E.K. nga Shkodra është një mike e familjes së saj me të cilën është njohur përpara se të largohej në Itali, ku jeton edhe sot. Si rezultat i kësaj marrëdhënieje subjektit i është dhënë mundësia të banojë në këtë apartamentin në periudhën kur ishte shtatzënë dhe bënte kontrolle mjekësore, si dhe përkohësisht punonte në Tiranë si ndihmësligjore në Gjykatën e Lartë. Kjo banesë i është dhënë në përdorim subjektit, duke qenë se nuk përdorej dhe mund të amortizohej nga mbajtja mbyllur dhe se qëndrimi i saj ishte provizor. Pas rikthimit në vendin e mëparshëm të punës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në nëntor të vitit 2015, subjekti dhe bashkëshorti i saj vendosën të vazhdonim të jetonim në Tiranë në këtë banesë. Në vijim ka lidhur kontratë qiraje me vlerën 14.000 lekë/muaj, pagesë e cila i është bërë *cash* z. A.H., meqenëse pronarja e banesës jetonte në Itali. Ky i fundit ka bërë edhe pagesat e faturave të energjisë elektrike dhe ujit përmes sistemit bankar, shuma të cilat subjekti ia ka dorëzuar *cash*.

3.8.1 Kontrata e qirasë më tej është rinovuar në heshtje me të njëjtat kushte, deri më 1.5.2019, kur subjekti e ka rinovuar me shkrim³², me afat 1-vjeçar, me pagesë qiraje 16.100 lekë/muaj. Kjo pagesë pas këtij afati i është bërë shtetasit A.H. përmes llogarisë bankare në emër të tij deri në datën 1.3.2020, kur është zgjidhur kontrata, për shkak se pronarja kishte si qëllim ta shiste apartamentin³³.

3.9 Komisioni hetoi lidhur me origjinën e kësaj prone dhe pas administrimit të dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “****” sh.p.k.³⁴ (dikur me emrin “****” sh.p.k.), rezulton se apartamenti nr. *** ndodhet në katin e gjashtë (i ***-të teknik), me sip. 59.4 m² dhe është porositur me kontratën e porosisë (kontratë e thjeshtë) datë 26.12.2008, nga shtetasi E.K. (banues në Romë). Kjo kontratë është nënshkruar nga shtetasi I.K., që rezulton të jetë vëllai i porositësit, por në asnjë pikë të kontratës nuk është përcaktuar se do të jetë në cilësinë e përfaqësuesit të shtetasit E.K.. Vlera e kontratës është 39.500 euro³⁵: kësti i parë 15.000 euro është likuiduar në datën 25.12.2008; kësti i dytë 15.000 euro është likuiduar në datën 30.8.2009; kësti i tretë 7.500 euro është likuiduar në datën 25.12.2009; dhe kësti i katërt 2.000 euro do të likuidohet kur porositësit do t’i jepej hipoteka e apartamentit.

3.10 Shoqëria “****” sh.p.k. shpjegon se kanë mundur të gjejnë vetëm një pjesë të dokumentacionit të pagesave të kryera për shkak kohës së gjatë që ka kaluar, dhe konkretisht ka vënë në dispozicion transfertën e kryer në datën 17.8.2009 nga porositësi I.K. në “Intesa Sanpaolo Bank” për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. në vlerën 5.500 euro, me përshkrimin “E.K., pagesë kësti për blerje apartamenti”; transfertën e kryer në datën 28.12.2008 nga z. E.K.

³² Nënshkruar midis personit të lidhur M.B. dhe znj. E.K., përfaqësuar nga i vëllai i saj A.H.

³³ Subjekti shpjegon se deri në datën 5.3.2020 ka vazhduar të jetojë në këtë banesë, koha e përshtatshme për të bërë transferimin në banesën tjetër të marrë me qira. Pas kësaj date ka lidhur kontratë qiraje me pronarët e banesës së ndodhur në rrugën “****”, pallati ***, apartament në gjendje faktike 2+1+2+verandë (kjo e fundit me sip. 70 m²) me sipërfaqe totale 130 m², identifikuar me nr. pasurie ***, z. k. ***, në pronësi të shtetasve A.D. dhe O.D., me vlerë qiraje 41.000 lekë/muaj, e cila që prej asaj date i paguhet *cash* pronarëve të banesës. Aktualisht subjekti, së bashku me familjen, jeton në këtë banesë.

³⁴ Shkresa e protokolluar në Komision me nr. **** prot., datë 4.9.2020.

³⁵ 59.4 m² * 700 euro/m² = 41.600 euro, mbi këtë çmim është aplikuar një ulje prej 2.000 euro.

në “Intesa Sanpaolo Bank” për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. në vlerën 4.000 euro, me përshkrimin “pagesë paradhënie për blerje apartamenti”; dhe transfertën e kryer në datën 29.12.2008, nga z. E.K. në “Intesa Sanpaolo Bank” për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. në vlerën 557.55 lekë (4.500 euro), me përshkrimin “pagesë paradhënie për blerje apartamenti”.

3.11 Kontrata e shitjes nr. ***, datë 5.10.2012, është lidhur mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe znj. E.K. (e ëma e porositësit I.K., i cili ka ndërruar jetë në një aksident automobilistik), përfaqësuar nga z. A.H.³⁶. Referuar kontratës së shitjes rezulton se kjo kontratë është lidhur për apartamentin me nr. ***, me sip. 55.1 m², në katin e ***-të të godinës. Vlera e apartamentit është 4.500.000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 8.1.2014, kjo pronë rezulton e regjistruar në emër të znj. E.K.

3.12 Në pyetësin nr. 2 subjekti deklaron se kanë banuar në këtë banesë deri më 5.3.2020, dhe pas kësaj date kanë lidhur kontratë qiraje me pronarët e banesës së ndodhur në rrugën “****”, pallati ***, apartament në gjendje faktike 2+1+2+verandë (kjo e fundit me sip. 70 m²) me sipërfaqe totale 130 m², identifikuar me nr. pasurie ***, z. k. ***, në pronësi të shtetasve A. dhe O.D., me vlerë qiraje 41.000 lekë/muaj, banesë në të cilën jetojnë edhe aktualisht.

3.13 Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këtë pasuri në përdorim, nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

3.14 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin të drejtat e përdorimit mbi këtë apartament dhe nuk u ngritën dyshime apo të kishte *indicie* për konflikt interesi dhe fshehje të pasurisë prej saj.

4. Automjet tip “Volkswagen Passat” me targa *, me vlerë 2.000 euro**

4.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Automjet në bashkëpronësi me bashkëshortin M.B., e blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 6.8.2013, me nr. shasje ***, marka ‘***’, me targa ***. Vlera: 2.000 euro. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara nga puna e subjektit dhe bashkëshortit*”. Për vërtetimin e deklarimeve të saj, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³⁷.

4.2 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DPV-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip ‘Volkswagen Passat’, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 6.8.2013, në bashkëpronësi me shtetasin M.B.*”.

4.3 Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja³⁸ konfirmohet se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur është i regjistruar automjeti me targa ***. Nga kontrolli i kryer në AMF rezulton se ky automjet është në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

4.4 Subjekti dhe bashkëshorti/personi i lidhur M.B. e kanë blerë këtë automjet me kontratën nr. ***, datë 6.8.2013, në shumën 2.000 euro (shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale).

4.5 Nga hetimi rezulton se fillimisht ky automjet është blerë në shumën 950 euro *140.24 = 133.228 lekë dhe shpenzimet doganore në shumën 31.151 lekë, në total shitësit i ka kushtuar 164.379 lekë.

4.6 Në pyetësin nr. 2 subjekti ka deklaruar se në vitin 2013 ka tërhequr shumën prej 450.000 lekësh nga llogaria në “Raiffeisen Bank”, e cila është përdorur për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Passat”, në bashkëpronësi, dhe pjesa tjetër është shpenzuar gjatë vitit 2013 për

³⁶ Prokurë nr. ***, datë 9.8.2012.

³⁷ Dosja e automjetit me targa ***, kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 6.8.2013, për automjetin tip “Volkswagen Passat”.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2020.

qëllime të tjera kryesisht konsumi. Shuma e tërhequr e ka burimin nga shlyerja e depozitës bankare të krijuar në datën 1.10.2012.

4.7 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank”³⁹ konstatohet se në datën 15.7.2013 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 450.000 lekë. Automjeti është blerë në datën 16.8.2013, ndërsa në datën 1.1.2013 gjendja e likuiditeteve *cash* ka qenë 300.000 lekë.

4.8 Për efekt të analizës financiare u konsiderua si kosto blerjeje 50% e vlerës së automjetit, konkretisht vlera 1.000 euro ose ekuivalenti 139.940 lekë⁴⁰, për subjektin e rivlerësimit dhe e njëjta vlerë për bashkëshortin.

4.9 Nga hetimi administrativ kryesish, bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2013 dhe bashkëshorti i saj ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive deri në fund të vitit 2013.

4.10 Në konkluzion, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe bashkë me personin e lidhur kanë burime të ligjshme financiare për blerjen e këtij automjeti.

5. Të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit në bashkëpronësi

5.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Të ardhura të përfituara nga shitja e autoveturës së markës ‘Opel’, tipi S93, me nr. shasie ***, me targa ***, në bashkëpronësi me motrën S.K., me datë shitjeje 7.7.2014, në shumën 140.000 lekë*”.

5.2 Në DPV-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip ‘Opel Corsa’ me vlerë 300.000 lekë, krijuar nga të ardhurat nga paga (prill 2008), në bashkëpronësi me motrën.*”

5.3 Në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Opel Corsa” me kontratën nr. ***, datë 7.7.2014, në shumën 140.000 lekë.

5.4 Nga hetimi i Komisionit, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, ky automjet është blerë me kontratën nr. ***, datë 19.4.2008, me palë blerëse Irida dhe S.K., në shumën 300.000 lekë⁴¹. Për efekt të analizës financiare u konsiderua 50 % e vlerës së automjetit. Në lëvizjet e llogarisë së “Tirana Bank”⁴² konstatohet se në datën 16.4.2008 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 306.000 lekë nga llogaria e pagës.

5.5 Më tej është shitur me anë të kontratës nr. ***, datë 7.7.2014, në shumën 140.000 lekë. Nga kontrolli i kryer në AMF rezulton se ky automjet ka qenë në pronësi të subjektit dhe motrës së saj deri në vitin 2014.

5.6 Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Kontratë për pajisje me kartë krediti e përfituar pa komision dhe me limit akreditimi prej 100.000 lekësh. Shuma e detyrimit: 1.286 lekë, blerje online*”. Për të vërtetuar deklaratimet e saj subjekti ka dorëzuar marrëveshjen e datës 10.4.2011, mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit, e lidhur me “Raiffeisen Bank”. Limiti i kartës është në vlerën 100.000 lekë, me afat 36 muaj.

5.7 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2020, ka konfirmuar llogari karte krediti në emër të subjektit të rivlerësimit, me gjendje 134,19 lekë.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 2.7.2020.

⁴⁰ Kursi i këmbimit në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë 1 euro = 139.94 lekë.

⁴¹ Referuar dokumentacioni bashkëlidhur, ky automjet ka kushtuar 900 euro + shpenzimet doganore në vlerën 101.298 lekë.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2020.

5.8 Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këto të ardhura nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

5.9 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këto të ardhura dhe ka burime të ligjshme me dokumentacion justifikues për krijimin e tyre.

6. Konstatime të tjera gjatë hetimit – krijimi i depozitës në shumën 200.000 lekë në “Raiffeisen Bank”

6.1 Në dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank”⁴³ konstatohet se në datën 24.1.2012⁴⁴ subjekti i rivlerësimit ka kryer një depozitim në shumën 200.000 lekë, ndërkohë që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 nuk janë deklaruar gjendje likuiditetesh *cash* (jashtë sistemit bankar) dhe nuk është tërhequr një shumë e tillë nga llogaritë bankare gjatë periudhës 1.1.2012 – 24.1.2012, por konstatohen vetëm disa tërheqje nga llogaria në “Tirana Bank” në shumën totale 35.000 lekë⁴⁵.

6.2 Subjekti u pyet lidhur me këtë fakt dhe në përgjigje të saj deklaroi se shuma 200.000 lekë ka të bëjë me të ardhurat e kursyera prej saj në vitin 2011 dhe deri më 23.1.2012, dhe më tej të depozituara në datën 24.1.2012. Ndërkohë, sipas subjektit, deklarata periodike e vitit 2011 është depozituar në ILDKPKI në datën 23.3.2012 dhe në datën e deklarimit të DPV-së së vitit 2011 nuk e dispononte shumën prej 200.000 lekësh *cash* në banesë, për sa kohë ishte depozituar në bankë dhe kjo ka qenë arsyeja që nuk e ka deklaruar gjendjen *cash* në deklaratën e këtij viti, pasi kishte menduar që këto para ishin tashmë të depozituara në bankë.

6.3 Komisioni vëren se, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes së kursimeve *cash* në vitin përkatës, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Ndërkohë që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 subjekti nuk ka deklaruar likuiditete *cash*, por vetëm depozitimin e shumës 200.000 lekë, pa deklaruar burimin.

6.4 Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, subjektit iu kaluar barra e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova në lidhje me konstatimin se: subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për depozitimin e shumës 200.000 lekë në “Raiffeisen Bank” në datën 23.1.2012.

6.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj në lidhje me këtë konstatim, deklaroi se: *“Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 e kam depozituar pranë ILDKPKI-së në datën 23.3.2012 dhe në datën e deklarimit të DPV-së së vitit 2011 nuk e disponoja shumën prej 200.000 lekësh cash në shtëpi, për sa kohë ajo ishte depozituar në bankë dhe kjo ka qenë arsyeja që nuk e kam deklaruar gjendjen cash në DPV-në e vitit 2011, pasi kam menduar që këto para ishin tashmë të depozituara në bankë dhe do i deklaroja në vitin pasardhës, siç edhe ka ndodhur”*.

6.6 Më tej, subjekti shpjegoi se në lëvizjet e llogarisë së saj në “Tirana Bank” për periudhën 1.10.2011 – 24.1.2012 konstatohet se janë tërhequr vazhdimisht shuma që në total e kalojnë vlerën 200.000 lekë dhe, për rrjedhojë, shuma e depozituar në “Raiffeisen Bank” është krijuar me burime të ligjshme të mjaftueshme të saj me burim nga paga si gjyqtare. Subjekti paraqiti

⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 2.7.2020.

⁴⁴ Lidhur me depozitimin e shumës 200.000 lekë në datën 2.2.2009 në “Raiffeisen Bank” konstatohet një tërheqje në të njëjtën shumë dhe në të njëjtën datë nga “Tirana Bank”.

⁴⁵ Tërhequr shumë: 7.000 lekë në datën 3.1.2012; 10.000 lekë në datën 4.1.2012; 3.000 lekë në datën 12.1.2012; 3.000 lekë në datën 16.1.2012; 4.000 lekë në datën 17.1.2012; 4.000 lekë në datën 20.1.2012; dhe 4.000 lekë në datën 23.1.2012.

një analizë për periudhën 1.10.2011 – 24.1.2012, ku evidentohen tërheqjet në shumën 296.000 lekë; të ardhura nga babai nga pensioni i pleqërisë në shumën 52.344 lekë; të ardhura nga nëna nga pensioni i pleqërisë në shumën 45.418 lekë; shpenzime jetike për 4 muaj në shumën 136.620 lekë; dhe shumën e depozituar prej 200.000 lekësh, duke rezultuar në një balancë pozitive prej 57.145 lekësh. Përfundimisht, duke iu referuar analizës financiare të mësipërme, subjekti deklaroi se për periudhën 1.10.2011 – 24.1.2012, për krijimin e depozitës bankare në vlerën 200.000 lekë, janë përdorur të ardhura të ligjshme nga paga e saj.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

6.7 Komisioni theksoi se mbështetur në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur detyrimin të deklaronin çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes së kursimeve *cash*, nëse kjo kishte ndodhur në vitin përkatës. Në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin “ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, kërkohet nga deklaruesit: *“Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: [...] të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit”*.

6.8 Në përfundim të analizimit të burimit të ligjshëm për krijimin e kësaj depozite dhe interpretimit ligjor në lidhje me deklarimin e kësaj shume në deklaratat periodike vjetore në ILDKPKI, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues për depozitimin e shumës 200.000 lekë.

6.9 Si konkluzion në lidhje me këtë pasuri, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri dhe, për rrjedhojë, nuk ka burime të ligjshme financiare për krijimin e saj.

Pasuritë e bashkëshortit të subjektit

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. M.B., në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar veçmas këto pasuri në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 dhe iu nënshtrua hetimit administrativ, si vijon:

7. Pasuri e paluajtshme arë + truall, me sipërfaqe 750 m²

7.1 Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur ka deklaruar: *“Pronësi mbi pasurinë e paluajtshme arë + truall me sip. 750 m² nga të cilat 200 m² truall dhe 102 m² ndërtim (shtëpi banimi) dhe pjesa tjetër arë, me nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në D., Shkodër, me certifikatë pronësie datë 25.5.2001 – pasuri e fituar me trashëgimi dhe ligji ‘Për tokën’. Pjesa takuese: 16.6 %. Burimi i krijimit: pasuri e fituar me trashëgimi dhe ligjin ‘Për tokën’”*. Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të bashkëshortit, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁴⁶.

7.2 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se sipas dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, certifikatës së pronësisë datë 25.5.2001, pasuria e llojit “arë + truall”, me sip. 750 m² (nga kjo truall 200 m² dhe ndërtesë 102 m²), me nr. pasurie ***, e ndodhur në D., Shkodër, figuron e regjistruar në emër të shtetases A.B. (vjehera e subjektit).

7.3 Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Shkodër⁴⁷, me anë të AMTP-së me nr. regj. të aktit ***, konfirmohet se në emër të shtetases A.B. është e regjistruar pasuria

⁴⁶ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 25.5.2001, për pasurinë e llojit “arë + truall”, me sipërfaqe totale 750 m², harta treguese e pasurisë.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 9.9.2020.

me nr. ***, me sipërfaqe totale 750 m² arë, nga kjo truall me sip. 200 m² dhe ndërtesë me sip. 102 m² (regjistruar fillimisht 775 m², nga të cilat 300 m² truall).

7.4 Më anë të pyetësorit nr. 2 subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion mbi investime të mundshme në këtë pronë pas vitit 2007 dhe nëse bashkëshorti i saj ka kontribuar financiarisht në këtë investim.

7.5 Në përgjigje të saj subjekti deklaroi se banesa nuk ka asnjë shtesë, ndryshime strukturore apo përmirësime të kryera pas vitit 2007. Subjekti shpjegoi se kjo banesë përbëhet nga 2 dhoma, një tualet, korridor dhe aneks, në katin e parë, një palë shkallë druri që të drejtojnë në katin e dytë, 2 dhoma dhe një korridor në katin e dytë, si dhe është e mbuluar me çati me tjegulla. Subjekti vijon se nga biseda me bashkëshortin (meqenëse bëhet fjalë për një periudhë në të cilën ajo nuk kam jetuar në atë banesë dhe as ka qenë e martuar), ai referon se banesa është ndërtuar rreth vitit 1960 nga babai dhe gjyshërit e tij; se në të nuk janë kryer investime pas vitit 2007; se banesa është e vjetër dhe se nuk kanë investuar, pasi mendonin që ta shisnin përpara disa viteve, por nuk kanë arritur të sigurojnë një çmim të mirë shitjeje dhe prandaj kanë hequr dorë. Subjekti deklaroi se pas lidhjes në martesë nuk kanë investuar në këtë banesë, pasi kursimet e tyre donin t'i investonin për blerjen e një banese në Tiranë. Më tej, ajo shpreh disponueshmërinë e saj dhe të bashkëshortit për këqyrjen e kësaj banese në çdo moment nga Komisioni.

7.6 Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se deklarimi i subjektit dhe personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

7.7 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se personi i lidhur ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe e ka fituar këtë pasuri në një nga format ligjore të parashikuara në Kodin Civil.

8. Pasuri e paluajtshme arë, me sipërfaqe 11.529 m²

8.1 Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur ka deklaruar: “*Pronësi mbi pasurinë e paluajtshme tokë arë, me sip. 11.529 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në D., Shkodër, me certifikatë pronësie datë 26.4.2000. Pjesa takuese: 16.6 %. Burimi i krijimit: pasuri e fituar nga ligji ‘Për tokën’*”. Subjekti për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁴⁸.

8.2 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se sipas dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, certifikatës së pronësisë datë 25.5.2001, pasuria nr. ***, ndodhur në D., Shkodër, e llojit “arë”, me sip. 11.529 m², figuron e regjistruar në emër të shtetases A.B.

8.3 Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Shkodër⁴⁹, me anë të AMTP-së me nr. regj. të aktit ***, konfirmohet se shtetases A.B. i është dhënë në pronësi pasuria arë, me sip. 775 m², nga e cila 475 m² arë dhe 300 m² truall + arë me sip. 1.872 m² + arë me sip. 10.753 m², gjithsej me sip. 13.100 m² arë, nga të cilat 300 m² truall.

8.4 Sipas kartelës së pasurisë në emër të shtetases A.B. ka qenë e regjistruar pasuria me nr. ***, me sipërfaqe totale 2016 m² (arë), e cila me kontratën nr. ***, datë 26.4.2000, e ka shitur këtë pasuri me çmimin 1.100.000 lekë, pronë e cila tashmë figuron në emër të blerësit F.D.

⁴⁸ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 25.5.2001, për pasurinë e llojit “arë” me sipërfaqe totale 11.529 m², me nr. pasurie ***, në D., Shkodër, regjistruar në emër të shtetases A.B., harta treguese e pasurisë.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 9.9.2020.

8.5 Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se deklarimi i subjektit dhe personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

8.6 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se personi i lidhur ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka fituar këtë pasuri në një nga format ligjore të parashikuara në Kodin Civil.

9. Automjet tip “Mercedes-Benz” me targa *, me vlerë 300.000 lekë**

9.1 Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur ka deklaruar: “*Pronësi mbi automjetin tip “Mercedes-Benz”, me nr. shasie ***, me targa ***, në bashkëpronësi me të motrën F.B. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %*”. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve të bashkëshortit subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵⁰.

9.2 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRr-ja⁵¹, automjeti me targa *** nuk rezulton i regjistruar në emër apo në bashkëpronësi të personit të lidhur/M.B. dhe motrës së tij F.B. Nga kontrolli i kryer në AMF⁵² rezulton se ky automjet figuron në emër të shtetasve M. dhe F.B.

9.3 Sipas kontratës nr. ***, datë 11.3.2005, ky automjet është blerë nga shtetasit M. dhe F.B., me çmim 250.000 lekë (likuiduar jashtë zyrës noteriale), ndërkohë që është deklaruar në vlerën 300.000 lekë.

9.4 Sa më sipër rezulton, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1,⁵³ i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me burimin e krijimit, vlerën e kontributit të znj. F.B. dhe mospërputhjen midis çmimit të deklaruar dhe atij të kontratës.

9.5 Në përgjigje⁵⁴ të saj, subjekti deklaroi se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë kursimet e bashkëshortit dhe motrës së tij⁵⁵. Kontributi i znj. F.B. në blerjen e këtij automjeti ka qenë në masën 50 %. Në lidhje me mospërputhjen mes çmimit të blerjes, subjekti shpjegon se vlera prej 300.000 lekësh është një lapsus i bashkëshortit dhe ka ardhur si pasojë e mosdisponimit të kopjes së kontratës në momentin e deklarimit në DPV-në e vitit 2014. Ky deklarim është bërë mbi bazë memorie, më tej, gabimi i vlerës është kopjuar në deklaratën *Vetting*. Çmimi i saktë është ai i shënuar në kontratën e blerjes, prej 250.000 lekësh.

9.6 Për efekt të analizës financiare u konsiderua si kosto blerjeje 50 % e vlerës së automjetit, konkretisht vlera 125.000 lekë për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit dhe e njëjta vlerë për motrën e tij.

9.7 Referuar analizës financiare të bashkëshortit, rezulton një balancë pozitive pas analizimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe pasurive për periudhën 2004 – 2013.

⁵⁰ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 11.3.2005, për automjetin tip “Mercedes-Benz”, leje qarkullimi datë 11.3.2005, dhe datë 17. 8.2010, në emër të shtetasve F. dhe M.B., dosja e automjetit me targa *** (***)

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2020.

⁵² Gjithashtu, nga kontrolli i kryer në AMF rezulton se shtetasi M.B., për vitet 2009 – 2011 ka qenë përdorues i automjetit tip “LADA”, me targa ***.

⁵³ E-mail datë 15.9.2020, ora 15:30.

⁵⁴ E-mail datë 20.9.2020, ora 21:11.

⁵⁵ Shtetasja F.B. ka punuar nga viti 1995 si sekretare ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër (vërtetim page datë 16.9.2020, për periudhën e punës nga viti 1999 – 2001. Kjo gjykatë është djegur në vitin 1998. Nga data 1.6.2001 ajo është regjistruar si Person Fizik (biznes i vogël), notere (vërtetuar me certifikatën e regjistrimit në organin tatimor dhe ekstraktin e QKB-së), veprimtari të cilën e vazhdon edhe sot. Subjekti, në mbështetje të deklarimeve të saj, dorëzoi një fletë njoftimi dhe detyrimit tatimor, datë 4.2.2004, për vitin ushtrimor 2003, lëshuar nga Dega e Tatim-Taksave, Shkodër.

9.8 Lidhur më të ardhurat e motrës së bashkëshortit, subjekti ka dorëzuar: vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për shtetasen F.B., për periudhën 1.1.1999 – 15.9.2001, ku totali i pagave *neto* rezulton në shumën 332.893 lekë; fletë njoftimin e detyrimit tatimor, datë 4.2.2004, lëshuar nga Dega e Tatim-Taksave Shkodër, nga ku rezulton se xhiroja e realizuar për vitin paraardhës, pra për vitin 2003, ka qenë 1.800.000 lekë; shkresën⁵⁶ nr. *** prot., datë 28.9.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, ku, për vitin 2005 pasqyrohet qarkullimi në shumën 2.433.339 lekë.

9.9 Nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive deri në fund të vitit 2013 dhe motra e bashkëshortit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e shumës 125.000 lekë për blerjen e pjesës takuese të automjetit.

9.10 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se personi i lidhur ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

Pasuritë e prindërve të subjektit

10. Apartament banimi me sipërfaqe 70 m²

10.1 Në deklaratën *Vetting* janë deklaruar pasuritë dhe të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit.

10.2 Në pyetësorin standard, subjekti shpjegon se në deklaratën *Vetting* ka deklaruar pasurinë e prindërit e saj, S. dhe Y.K., edhe pse ata nuk janë persona të lidhur me të si subjekt i deklarimit, në kuptim të pikës 13 të nenit 3 dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, pasi është martuar në datën 17.3.2014 dhe prindërit nuk bëjnë pjesë në certifikatën e saj familjare, por deklarimi është bërë vetëm për transparencë.

10.3 Në deklaratën *Vetting*, në emër të prindërve të subjektit është deklaruar pronësia mbi pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sip. 70 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e ndodhur në Shkodër, bulevardi “****”, me certifikatë pronësie datë 7.4.2008 – pasuri e fituar me kontratë privatizimi⁵⁷.

10.4 Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Shkodër⁵⁸ konfirmohet se në emër të shtetasve Y. dhe S.K. është e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me sip. 70 m², ndodhur në Shkodër, përfituar me anë të privatizimit, me aktin e shitjes nr. ***, datë 14.7.1993, në shumën 17.052 lekë.

10.5 Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

10.6 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasuritë e prindërve dhe e ka fituar këtë pasuri në një nga format ligjore të parashikuara në Kodin Civil.

11. Llogari rrjedhëse në vlerën 478.272 lekë

⁵⁶ Dorëzuar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

⁵⁷ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 7.4.2008, regjistruar në emër të shtetasve Y. dhe S.K., harta treguese e regjistrimit të pasurisë.

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 9.9.2020.

11.1 Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në emër të shtetases S.K., e krijuar në datën 30.7.2012, me të ardhura nga kursimet e familjes. Vlera: 478.272 lekë⁵⁹. Pjesa takuese: 100 %.

11.2 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, gjendja e llogarisë rrjedhëse në datën 20.1.2017 ka qenë në shumën 473.458,10 lekë. Deklarimi i shumës 478.272 lekë i nënës së subjektit duket t’i jetë referuar rreshtit me emërtimin “numri i veprimeve në kredi” të dokumentit “nxjerrje llogarie”, dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

11.3 Konstatohet se kjo gjendje ka ardhur si rrjedhojë e disa depozitimeve në vitet 2015 dhe 2016⁶⁰, të cilat janë kaluar në depozita me afat 1-vjeçar, të maturuara përpara datës 20.1.2017, pra, nuk janë krijuar gjatë periudhës së jetesës së përbashkët me subjektin.

12. Depozitë bankare në vlerën 214.042 lekë

12.1 Depozitë në “Raiffeisen Bank” sh.a., në emër të shtetasit S.K., e krijuar në datën 30.7.2012, me të ardhura në vite nga kursimet e familjes. Vlera: 214.042 lekë⁶¹. Pjesa takuese: 100 %.

12.2 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank” sh.a., konfirmohet gjendja e llogarisë së deklaruar. Konstatohet se kjo depozitë bankare është krijuar fillimisht me një depozitim në datën 30.7.2012, në shumën 200.000 lekë.

12.3 Për sa i përket ligjshmërisë së burimit të krijimit është kryer analiza financiare për subjektin dhe prindërit, ku balanca e vitit 2012 është pozitive.

12.4 Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit në lidhje me një llogari rrjedhëse dhe një depozitë me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

12.5 Subjekti ka parashtruar në prapësime pretendimet e tij në lidhje me pasqyrimin e fitimit *neto* nga aktiviteti i bashkëshortit edhe pse nuk i është kaluar barra e provës, duke e lidhur këtë pretendim me balancën negative të vitit 2016 në vlerën -209.434 lekë. Subjekti kërkoi të merren në konsideratë lëvizjet bankare të personit fizik në “Credins Bank” sh.a., në llogarinë në lekë dhe atë në euro në raport me shpenzimet e aktivitetit tregtar për vitin 2016⁶², të cilat do të çonin në një fitim *neto* në shumën 558.578 lekë, përkundrejt shumës 147.058 të përlllogaritur nga Komisioni.

12.6 Komisioni vëren se në kushtet kur mungon informacioni lidhur me lëvizjet e mundshme të likuiditeteve jashtë sistemit bankar (në arkën e personit fizik) gjatë vitit 2016 dhe mungesës së pasqyrave financiare për vitin 2015, dokumentacioni i vetëm të cilit mund t’i referohet Komisioni janë pasqyrat financiare të vitit 2016 përcjellë nga DPT-ja⁶³.

12.7 Në çdo rast, Komisioni thekson se balanca negative në fund të vitit 2016 vjen si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme lidhur me shumën 10.000 euro të investuar në “Raiffeisen Invest” në mars të vitit 2016, arsye për të cilën balanca negative e vitit 2016 nuk është kaluar si barrë prove në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

⁵⁹ Kontratë llogari rrjedhëse datë 30.7.2012, nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” datë 9.1.2017.

⁶⁰ Datë 5.1.2015, vlera 120.000 lekë; datë 13.5.2015, vlera 90.000 lekë; datë 25.4.2016, vlera 126.000 lekë; datë 23.12.2016, vlera 138.200 lekë.

⁶¹ Kontratë depozite me afat datë 30.7.2012, e lidhur midis shtetases S.K. dhe “Raiffeisen Bank”. Shuma e investuar: 200.000 lekë; nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” datë 9.1.2017, për çelje depozite në datën 1.8.2016, në vlerën 214.042 lekë.

⁶² Emërtimi i tabelës së paraqitur nga subjekti është periudha 1.1.2015 – 3.12.2015, por përmbajtja dhe arsyetimi i referohen vitit 2016.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2020, dokumenti me emërtim “M.B. Pasq. e M. 2016”.

12.8 Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

12.9 Komisioni, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën pamjaftueshmërisë në shumën 684.900 lekë, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

12.10 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

31. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

32. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 1.3.2019, të KDZH-së dhe shkresën e përditësuar nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 30.6.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

32.1 Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administron prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Irida Kacerja.

32.2 Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

32.3 Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës, nuk ka të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

33. Nga hetimi administrativ i Komisionit nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

33.1 Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, **duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.**

33.2 Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

34. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

35. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional si vijon.

35.1 Ky raport vlerësimi ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

35.2 Ky vlerësim është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe të dhënave nga burimet arkivore të KLGj-së.

36. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 6.7.2004 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2008. Pas studimeve, në datën 25.3.2009 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më pas, znj. Irida Kacerja, me vendimin nr. ***, datë 15.11.2012, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar ndihmësligjore në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më 13.11.2015, kur me vendimin nr. *** të KLD-së është rikthyer në detyrën e mëparshme në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku vazhdon dhe aktualisht.

Aftësitë profesionale

37. Njohuritë ligjore – subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën penale, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se përgjithësisht identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit në rastin konkret, në çështjet penale. I kushton rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale, si dhe ndalet me kujdes te vlerësimi i provave të shqyrtuara.

Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit deri te arsyetimi i vendimit gjyqësor. Karakteristikë e opinioneve të hartuara në funksionin e ndihmësligjores është pasqyrimi i detajuar i rrethanave të çështjes, pretendimet e parashtruara para Gjykatës së Lartë, si dhe analiza e çështjes në të cilën evidentohen pretendimet e ngritura nga rekursuesi, të cilat analizohen në frymën e gjykimit në nivel të lartë, bazuar në normat kushtetuese dhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese.

38. Arsyetimi ligjor – subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përgjithësisht janë të qarta dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar dhe arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga praktika e Gjykatës Kushtetuese. Një tipar i mirë i punës së saj është fokusimi i arsyetimit të vendimit te thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetimin e tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendim nga gjykata e apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët. Gjithashtu është konstatuar se subjekti i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

Aftësitë organizative

39. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë – gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e ndihmësligjores në Gjykatën e Lartë, subjektit i janë caktuar gjithsej 366 çështje dhe ka përfunduar gjithsej 366 relacione. Gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër i janë caktuar gjithsej 538 çështje, ka përfunduar 426 çështje, si dhe ka mbartur gjithsej 122 çështje të vitit 2016.

39.1 Në analizën e këtyre të dhënave për të konkluduar mbi aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë si ndihmësligjore, duhen evidentuar tre faktorë: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar numrin e çështjeve për relativitet që i janë caktuar dhe, rrjedhimisht, rendimenti i punës së saj përcaktohet i plotë për të përballuar ngarkesën në punë; (ii) kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësligjorin e Gjykatës së Lartë; (iii) mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për relativitet dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësligjorja bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion të ndihmësligjores së përzgjedhur me short për vlerësim.

39.2 Sa i përket periudhës tjetër të rivlerësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, subjekti Irida Kacerja për afro një vit ka kryer detyrën e gjyqtares, njëkohësisht, në dhomën civile e penale. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

40. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore – në të gjitha praktikat e administruara nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga ndihmësligjori, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. Nga përmbajtja e katër dokumenteve ligjore dhe relacioneve gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si ndihmësligjore konstatohet se subjekti ka studiuar dhe relatuar çështjen

gjqësore për çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e rekursit⁶⁴.

40.1 Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së saj. Gjatë gjykimit vërehet se identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, te pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar i palëve e deri te shpallja e vendimit.

41. *Aftësia për të administruar dosjet* – dosjet kanë rezultuar të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse e më pas ato të krijuara nga gjykata. Gjithashtu, ato rezultojnë të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

42. *Etika në punë* – sipas dosjeve të vëzhguara dhe të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen problematika lidhur me etikën në punë të subjektit të rivlerësimit, znj. Irida Kacerja.

43. *Integriteti* – nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

44. *Paanësia* – nga dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Irida Kacerja. Nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve, si dhe nuk janë konstatuar elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

45. *Aftësia e komunikimit* – konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e saj. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtarës dhe as kërkesa të saj për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

46. *Aftësia për të bashkëpunuar* – nuk evidentohen problematika në bashkëveprimin e subjektit të rivlerësimit gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e ndihmësligjorit dhe gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

47. *Gatishmëria për t'u angazhuar* – subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë në 13 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 27 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale. Subjekti i

⁶⁴ Këto veprime subjekti i rivlerësimit i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar elementët proceduralë sipas kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 25 të rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. ***, datë 12.9.2014 të kryetarit të kësaj gjykate.

rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë pjesë edhe në 4 aktivitete të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, në 7 ditë gjithsej.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGj-së

48. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për gjyqtaren Irida Kacerja rezultoi se janë paraqitur 3 ankesa (1 në vitin 2013, 1 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. Të tria ankesat janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, pasi për dy prej tyre pretendimet për ligjshmëri vendimi zgjidheshin përmes apelimit gjyqësor në gjykatat e shkallëve më të larta, ndërsa 1 ankesë përmbante pretendime të përgjithshme dhe ishte e paplotë, si dhe nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

48.1 Me qëllim verifikimin e këtyre ankesave ndaj subjektit të rivlerësimit, Komisioni kërkoi informacion nga Ministria e Drejtësisë⁶⁵ në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga periudha 2006 e deri më sot. Pas administrimit të përgjigjes⁶⁶, Komisioni vëren se ndaj subjektit Irida Kacerja janë depozituar 5 ankesa: 1 ankesë e Operatorit të Sistemit të Transmetimi sh.a.; 3 ankesa nga shtetasi P. N. dhe 1 ankesë e shtetasit G. Sh., për të cilat është vendosur arkivimi i tyre. Më tej rezultoi se Ministria e Drejtësisë ka kryer inspektim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër, me qëllim verifikimin e procedurave gjyqësore të zbatuara në çështjen penale caktim mase sigurimi për ekstradimin e shtetasve shqiptar Q. A. dhe Z. A. nga Republika e Shqipërisë në SHBA.

48.2 Pas inspektimit të kryer nga Ministria e Drejtësisë, konkluzionet për subjektin e rivlerësimit kanë qenë: shkelje e rregullave procedurale për vleftësimin e caktimit të masës shtrënguese dhe afatit të saj sipas neneve 493 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe shkelje e nenit 11 të Traktatit të Ekstradimit midis SHBA-së dhe Shqipërisë, datë 1.3.1933; dhe shkelje e detyrimit ligjor të nenit 113 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen brenda 5 ditëve nga bërja e tyre. Gjyqtarja ka depozituar dy vendimet përfundimtare dhe fashikujt e gjykimit në sekretari në ditën e shtatë të shpalljes së vendimit.

48.3 Komisioni, pasi analizoi vendimet e dhëna, vëren se në arsyetimin e saj subjekti i rivlerësimit ka dalë në përfundimin se nuk ekziston rreziku që personat e dyshuar të largohen dhe të kryejnë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Gjykata ka pranuar kërkesën e prokurorisë në caktimin e një mase provizore prej 40 ditësh, por ka caktuar masat shtrënguese: “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore, çdo ditë të hëne dhe të enjte, ora 11:00” dhe “ndalim të daljes jashtë shteti”. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. *** dhe ***, datë 8.2.2012, ka vendosur: “*Miratimin e vendimeve nr. *** dhe ***, datë 16.1.2012, të gjykatës së shkallës së parë, me këtë ndryshim: Caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të dyshuarve në atë të ‘arrest në shtëpi’*”.

48.4 Në përfundim, Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara në KLD dhe në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore, të analizuar nga KLGJ-ja, vlerëson se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2020.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 23.6.2020, e Ministrisë së Drejtësisë.

DENONCIME NGA PUBLIKU

49. Në Komision, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, janë administruar 12 denoncime nga publiku.

49.1 Në 6 prej këtyre denoncimeve, në të cilat ngrihen pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit për dhënien e vendimeve të padrejta, Komisioni vlerësoi se nuk përmbanin fakte apo rrethana që mund të përbënin prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit të subjektit, respektivisht: (1) denoncimi nr. *** prot., datë 24.11.2017, i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 16.3.2018, i shtetasit Sh. H.; (3) denoncimi nr. *** prot., datë 5.12.2018, i shtetasës B. N.; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 13.2.2019, i shtetasës M. Q.; (5) denoncimet nr. *** prot., datë 20.11.2019 dhe nr. *** prot., datë 12.12.2019, të shtetasit N. M.

49.2 Në përfundim, Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe me themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

49.3 Në 6 nga denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për sa vijon:

1. Denoncimi nr. * prot., datë 8.2.2019, i shtetasit G. Y., i administruar në Komision**

Shtetasi ka ngritur padi ndaj 3 gjyqtarëve dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, znj. Irida Kacerja. Përveç të tjerash, në padinë e tij, ky denoncues kërkon detyrimin e subjektit Irida Kacerja dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, solidarisht, për ta dëmshpërblyer për dëmin jopasuror të shkaktuar ndaj tij, për shkak të mosmarrjes së masave nga e paditura Irida Kacerja për ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë, diskriminimit të tij në cilësinë e paditësit. Komisioni vëren se denoncuesi në fjalë, bashkëlidhur ankimit të paraqitur, nuk ka paraqitur asnjë provë mbi të cilat mbështet pretendimet e tij.

Më tej, Komisioni konstaton se me shkresën nr. *** prot., datë 1.4.2019, në Komision janë paraqitur prapësimet e gjyqtarës Irida Kacerja, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila shpjegon: “Në datën 6.2.2019, më është komunikuar kërkesëpadi, ku jam me cilësinë e palës së paditur, padi e ngritur nga shtetasi G. Y. Bazuar në nenet 154, 154a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile, padia duhet kthyer duke qenë se paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë⁶⁷”.

⁶⁷ “Kërkesëpadi në thelb ka të bëjë me një vendim të marrë nga ana ime lidhur me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarës A. Ll., nga gjykimi i një çështjeje civile. Pretendohet se e kam vënë në pozita të disfavorshme dhe diskriminuese, në krahasim me një person tjetër, me emrin B. Ll. (që paditësi pretendon se është vëllai i gjyqtarës A. Ll.). Në kërkesëpadi pretendon se meqenëse këtij shtetasi i është pranuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit A. Y. (që paditësi pretendon se është vëllai i tij), nga gjykimi i çështjes civile ku ai ishte palë. Në këtë mënyrë, me këtë kërkesë, ky shtetas kërkon që unë të zbatoj një vendim të një gjyqtari tjetër, në kushte që pretendon se janë identike, duke zbatuar kështu një burim të së drejtës që është precedenti, por që në fakt në sistemin tonë të së drejtës nuk përbën burim, përveç vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë. Mbetet enigmatike edhe mënyra se si është vënë në dijeni ky shtetas për vendimin e marrë nga gjyqtare E. D., kur këto vendime u komunikohen vetëm gjyqtarit që kërkohet përjashtimi dhe palëve ndërgjyqëse dhe gjithashtu është një vendim që nuk publikohet. Me këtë kërkesëpadi po ushtrohet ankimi ndaj një vendimi të marrë mbi bazën e një kërkesë për

Pavarësisht sa më lart, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me ecurinë e këtij procesi, ku subjekti i rivlerësimit figuronte në cilësinë e të paditurës.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, deklaroi se paditësi G. Y., ka paraqitur një kërkesëpadi abuzive dhe nuk ka asnjë provë mbi të cilat ngre pretendimet e tij. Në lidhje me ecurinë e këtij procesi gjyqësor rezultoi se me vendimin nr. *** (***), datë 3.7.2019, Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit G. Y., si e pabazuar në prova dhe ligj”. Më tej, subjekti deklaroi se kjo padi është rrëzuar për shtetasit Irida Kacerja dhe A. Ll. dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ndërsa për gjyqtaren E. D., paditësi ka preferuar të heqë dorë, duke u pushuar gjykimi përpara dhënies së vendimit përfundimtar⁶⁸.

Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi vendimin nr. ***, datë 3.7.2019, të Gjykatës Administrative të Rrethit Gjyqësor Shkodër, paraqitur në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se gjykata ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesëpadie si të pabazuar në prova dhe ligj dhe, në këto kushte, vlerëson se ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

2. Denoncimi nr. * prot., datë 25.7.2019, i shtetasit Gj.Sh., i administruar në Komision**

Shtetasi ankohet për zvarritje të gjykimit, njëanshmëri në gjykim, si dhe ngre pretendime për rryshfet dhe paaftësi profesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Nga analizimi i materialeve bashkëlidhur denoncimit, Komisioni vëren se denoncuesi Gj. Sh. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për lëshimin e urdhërkërkutimit për deklaraten noteriale për njohje detyrimi nr. ***, datë 6.3.2019. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 13.3.2019, ka vendosur kthimin e kërkesës së kërkuesit Gj. Sh., me arsyetimin se nuk ka provuar origjinën e shumës së parave të shprehura në deklaraten noteriale objekt gjykimi. Sipas arsyetimit të subjektit, deklarata e mësipërme përmban një shumë të madhe të hollash prej 120.000 euro, për origjinën e së cilës nuk ka të dhëna dhe sipas ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe ka lindur detyrimi për noterin për ta deklaruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Tiranë, gjë që sipas subjektit konstatohet se nuk ka ndodhur.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim denoncuesi Gj. Sh. dhe Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 3.6.2019, arsyeton se vendimi i shkallës së parë është marrë në shkelje të ligjit procedural civil dhe atij material dhe, për rrjedhojë, ky vendim duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rigjykim në shkallë të parë me të njëjtin trup gjykues.⁶⁹

përrjashtim gjyqtari, bazuar në nenet 72 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, ndaj të cilit pala mund të ankohet në shkallët e tjera të gjyqësorit dhe jo në një gjykatë të së njëjtës shkallë me gjykatën ku unë ushtroj funksionin si gjyqtare.”

⁶⁸ Subjekti deklaroi se ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke kërkuar bazuar në nenin 50, pika “d”, e ligjit nr. 49/2012, nenet 34, 158/a/2 pika “e”, 299/1 pika “c”, 466/1 pika “c” të Kodit të Procedurës Civile: Prishjen e vendimit nr. ***, datë 3.7.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke gjobitur paditësin për ngritjen e një padie abuzive në aplikim të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

⁶⁹ Gjykimi i kërkesës për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit lëshohet nga gjykata pa praninë e palëve dhe pa debat gjyqësor, por duke u mbështetur vetëm në provat e paraqitura nga kërkuesi. Gjykata e apelit vëren se gjykata e shkallës së parë ka bërë një interpretim të gabuar të nenit 154/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile, pasi në rastin konkret megjithëse gjykata konstaton të meta të padisë/kërkesës gjatë gjykimit, ajo jo vetëm që nuk ka njoftuar palët për këto të meta, duke i lënë një afat për plotësimin e tyre, por ia ka kthyer aktet kërkuesit. Gjykata e apelit çmon se vendimi për kthimin e padisë/kërkesës është një vendim jo përfundimtar, i cili në thelb duhet të merret nga gjykata, pasi me të metat formale që ajo paraqet nuk mund të jepet vendim mbi themelin e pretendimeve të ngritura me anë të saj. Për rrjedhojë, duke qenë se paditësi/kërkuesi mund ta riparaqesë sërish të njëjtën padi/kërkesë me plotësimin e të metave, ligjvënësi ka parashikuar mundësinë që gjykata t’i lërë një

Komisioni vëren se vendimi gjyqësor i paarsyetuar i dhënë nga subjekti është një vendim i metë dhe i cenueshëm edhe sikur vendimmarrja e tij të jetë në thelb e drejtë, pasi dëmton të drejtën e ankimit dhe të aksesit të palëve në gjykim. Gjithashtu, ky vendim nuk ka zgjidhur konfliktin mes palëve ndërgjyqëse, duke u bërë i paekzekutueshëm (pasi nga njëra anë shprehet për kthimin e akteve, nga ana tjetër vendos që prova kryesore të mbetet në dosje). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka respektuar pikën 1, të nenit 142, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 6, 14, 28 dhe 310 të Kodit të Procedurës Civile, për rrjedhojë, procesi gjyqësor pranë kësaj gjykate ka qenë i parregullt dhe vendimi i shkallës së parë është prishur duke e kthyer çështjen për rigjykim me të njëjtin trup gjykues.

Në analizë të sa më sipër, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konstatimin se: (i) gjykata, me vendimin nr. ***, datë 13.03.2019, nuk i ka lënë një afat paditësit/kërkuesit që të riparojë të metat e konstatuara në kërkesë; (ii) nga përmbajtja e pjesës arsyetuese të vendimit nuk arrihet të kuptohet se cila është e meta e kërkesës dhe në cilin ligj bazohet vendimmarrja e gjykatës. Mangësitë në arsyetimin e vendimit nuk janë gabime thjesht të karakterit material, të cilat nuk kanë ndikuar zgjidhjen në themel të çështjes, por janë të meta thelbësore të tij, për rrjedhojë këto gabime nuk kanë arritur të korrigjoheshin as nga Gjykata e Apelit, por çështja është kthyer për rigjykim me të njëjtin trup gjykues.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, në lidhje me konstatimin se Komisioni deklaroi se denoncuesi G. Sh. i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhërkzekutimit të deklaratës noteriale për njohje detyrimi, kërkesë e regjistruar në gjykatë në datën 11.3.2019 (5 ditë pasi është lëshuar deklarata noteriale, ku datat 9 dhe 10 janë ditë pushimi). Me vendimin nr. ***, datë 13.3.2019 (pra, 2 ditë nga paraqitja e kërkesës) është vendosur kthimi i saj pasi nuk është provuar origjina e shumës së parave të shprehura në deklaratën noteriale objekt gjykimi. Gjyqtari ia kthen paditësit/kërkuesit padinë/kërkesën në momentin e paraqitjes, pra, menjëherë ose në alternativë, i lë një afat për plotësimin e të metës. Pra, lënia apo jo afat për të metat është në disponimin e lirë të gjyqtarit, rast pas rasti, dhe nuk është kusht detyrues për të. Në rastin objekt gjykimi, meqenëse bëhej fjalë për një kërkesë, me objekt lëshim e urdhërkzekutimit, sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, sipas urdhërimeve të kësaj dispozite, shqyrtimi i kërkesës është zhvilluar pa praninë e palëve, pra, në dhomë këshillimi.

Ndodhur në kushtet e mungesës së informacionit, nëse noteri publik kishte njoftuar këtë drejtori, subjekti i ka kthyer aktet paditësit. Qëllimi i mbajtjes së deklaratës ishte vetëm dhënia e mundësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Tiranë, për të verifikuar nëse kishte të bënte me një rast të pastrimit të parave dhe jo për të dëmtuar interesat e kërkuesit. Mbajtja e këtij akti në fashikullin e gjykimit ishte për një interes publik, që shkon përtej interesit privat të kërkuesit, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në favor të tij. Detyrë e gjykatës është gjithmonë kontrolli i ligjshmërisë së çdo akti që i paraqitet në formën e provës, në proces gjyqësor.

Kërkuesi mund të realizonte të drejtat e tij, siç edhe në fakt ka ndodhur, përmes ankimit ndaj vendimit të dhënë nga subjekti. Gjithashtu, subjekti shprehet se deklarata noteriale nuk ekziston në një kopje të vetme pasi kopja e saj mund të merret pranë noterit publik, ku është

afat paditësit/kërkuesit që të riparojë të metat e konstatuara nga gjykata. I vetmi rast i parashikuar nga ligjvënësi për kthimin e menjëhershëm të padisë është në momentin e paraqitjes në gjykatë, por pa u regjistruar për gjykim. Më tej, gjykata e apelit vëren se edhe nga përmbajtja e pjesës arsyetuese të vendimit të shkallës së parë, nuk arrihet të kuptohet se cila është e meta e kësaj kërkesë dhe në cilin ligj bazohet vendimmarrja e gjykatës. Gjykata e apelit vlerëson se këto të meta dhe kontradikta të hapura të arsyetimit të vendimit të shkallës së parë nuk janë gabime thjesht të karakterit material, të cilat nuk kanë ndikuar zgjidhjen në themel të çështjes, por janë të meta thelbësore të tij, për rrjedhojë këto gabime nuk mund të korrigjoheshin as nga Gjykata e Apelit.

krijuar ky akt, prandaj çmon se nuk janë cenuar kurrsesi të drejtat e palës. Ky i fundit gjithashtu mund t'i drejtohej gjykatës me kërkesëpadi themeli, duke paditur palën debitore, ku të paraqiste prova për të provuar faktin e dhënies së këtyre shumave, palës debitore.

Për arsyet e dhëna më sipër, subjekti deklaroi se vendimi i dhënë prej saj është i plotë dhe i arsyetuar, pavarësisht arsyetimit të Gjykatës së Apelit Shkodër. Në rigjykimin e kësaj çështjeje, Gjykata e Apelit Shkodër, me një tjetër trup gjykues, ka lënë në fuqi vendimin e dhënë nga subjekti.

Komisioni, pasi shqyrtoi vendimin e paraqitur në cilësinë e provës nr. ***, datë 15.7.2019, "Për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit" lidhur me deklaratën noteriale të sipërtrajtuar me kërkesë Gj. SH., vëren se është vendosur rrezimi i kësaj kërkesë, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 14.10.2019.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm lidhur me konstatimet e evidentuara dhe arsyetimin e vendimit të saj dhe se ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 18.11.2020, i shtetasit F. Ç.**

Sipas pretendimeve të ngritura në denoncim rezulton se në vitin 2011 është urdhëruar fillimi i një procedimi disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, mbi bazën e një sërë ankesash nga disa qytetarë për zvarritje të proceseve gjyqësore, vonesa në zbardhjen e vendimeve, mungesë etike e sjellje në raport me palët, si dhe për përdorimin e pozitës së bashkëshortit të saj si avokat. Denoncuesi pretendon se në vitin 2011 ka hartuar relacionin paraprak të inspektimit lidhur me ankesat ndaj subjektit, relacion i cili duke qenë shumë i ashpër është ndryshuar nga kryeinspektorja V. V., e cila ka miqësi me gjyqtaren Irida Kacerja. Në këto kushte ankuesi deklaroi se u zëvendësua nga kolegu A. Q., i cili, gjithashtu, ka hartuar një raport konstatimi të shkeljeve të subjektit, por përsëri u favorizua nga KLD-ja.

Referuar *indicieve* në denoncim, Komisioni i është drejtuar përsëri KLGj-së lidhur me rastin e referuar, si dhe konkluzionet e arritura për këtë procedim disiplinor. Në përgjigjen nr. ***, datë 19.11.2020, KLGj-ja bën me dije se pas kërimit në arkivin e institucionit u konstatua gjetja e ankesës së shtetasit A. K., si dhe ankesa e shtetasit A. L. e vitit 2011.

Lidhur me ankesën e shtetasit A. K. – pas analizimit të dosjes së inspektimit, Komisioni vëren se për verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasi A. K., i cili ankohet për zvarritje të gjykimit nga subjekti i rivlerësimit, është urdhëruar inspektori A. Q. Në informacionin e hartuar prej tij është konstatuar se shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore nuk janë të motivuara, procesverbale të gjyqësore nuk janë të plotë dhe pas seancës së datës 25.3.2011 nuk figurojnë procesverbale të seancave gjyqësore në dosje. Ka zvarritje të qëllimshme të gjykimit dhe se perioda kohore e përfundimit të gjykimit të kësaj çështjeje është jashtë afateve të përcaktuara.

Evidentohet se kryeinspektorja e asaj kohe V. V., ka nxjerrë një tjetër urdhër për verifikimin e ankesës së paraqitur dhe konkluzioneve të inspektorit A. Q., duke urdhëruar inspektorët H. M. dhe F. Ç., sipas të cilëve është konstatuar se ka zvarritje të gjykimit pasi procesi gjyqësor deri në momentin e verifikimit ka zgjatur për një periudhë kohore rreth 1 vit e 3 muaj, duke shkelur afatet e përcaktuara në vendimin nr. ***, datë 15.9.2006, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, "Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore", si dhe ka shkelje të pajustificuara dhe të përsëritura të dispozitave urdhëruese procedurale lidhur me mënyrën e pasqyrimin të procesverbaleve gjyqësore.

Në përfundim, nga ana e KLD-së lidhur me këtë inspektim nuk u konstatuan zvarritje të qëllimshme të gjykimit nga gjyqtarja e përmendur më lart dhe, për pasojë, veprimet e saj nuk përbëjnë shkelje disipline në kuptim të nenit 32, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, por periudha kohore e përfundimit të gjykimit është tej afateve të përcaktuara në vendimin nr. ***, datë 15.9.2006, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, si rezultat do të merret parasysh për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.⁷⁰ Më tej është urdhëruar arkivimi i ankesës së paraqitur nga shtetasi A. K.

Nga hetimi i Komisionit, pasi u analizua dosja e inspektimit, rezultoi: (i) sipas procesverbalit të seancës së datës 9.12.2010 palët kanë dijeni me anë të fletëthirrjes për gjykim, por nuk përcaktohet data e gjykimit. Gjykata ka vazhduar gjykimin pa dalë me vendim për kalimin e çështjes nga seanca përgatitore në atë gjyqësore dhe pa shpallur trupin gjykues vazhdon parashtrimet e palëve në proces. Seanca gjyqësore e datës 11.2.2011 është shtyrë për kërkimin e provave, por nuk relatohet mbi prezencën e palëve, ndonëse palët paraqesin shkaqe për mungesën e tyre, gjykata nuk është shprehur, por ka vazhduar me kërkimin e provave, pa verifikuar pretendimet e palëve. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore procedurale të përcaktuara në nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile, lidhur me mënyrën e mbajtjes së procesverbalit gjyqësor⁷¹; (ii) gjithashtu, pas seancës së datës 25.3.2011 deri më 27.12.2011 nuk figuron procesverbal i seancave gjyqësore në dosje (gjithsej 9 seanca gjyqësore), si dhe nuk janë pasqyruar në sistem; (iii) më tej konstatohet se ka zvarritje të procesit gjyqësor, pasi gjykimi ka zgjatur gjithsej 1 vit e 3 muaj deri në momentin e verifikimit. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Sa më sipër rezultoi nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar dhe shpjeguar për sa konstatohet.

Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e saj në lidhje me konstatimin e Komisionit, duke u shprehur se në datën 26.2.2021 shtetasi F. Ç. ka lëshuar një deklaratë personale, ku deklaron se denoncimi i paraqitur nuk është përpiluar dhe dërguar prej tij, por dikush ka keqpërdorur emrin e tij. Lidhur me gjetjet në ankesën e shtetasit A. K. subjekti deklaroi se me vendimin nr. ***, datë 12.4.2010 ka vendosur moskompetencën tokësore dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë 10.6.2010, ka prishur këtë vendim dhe ka kthyer çështjen për rigjykim, me të njëjtin trup gjykues dhe dosja është kthyer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në tetor të vitit 2010. Pas kthimit për vazhdimin e gjykimit është formuar një fashikull tjetër që pjesërisht është inspektuar nga inspektorët, duke inspektuar vetëm procesverbalet dhe jo akte të tjera të dosjes.

⁷⁰ Lidhur me këtë rast në relacionin e hartuar nga kryeinspektori i KLD-së është konkluduar se: Gjykimi i çështjes objekt ankimi ka përfunduar në një periudhë kohore prej pothuajse 2 muaj e 17 ditë. Me vendimin nr. ***, datë 12.4.2010, gjyqtarja ka vendosur: “*Të deklarojë moskompetencën për shqyrtimin e çështjes civile nr. ***, datë 6.2.2010. Dërgimin e akteve gjykatës kompetente, konkretisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*”. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë 10.6.2010, vendosi: “*Prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes në atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit*”. Dosja e rikthyer për gjykim është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 15.10.2010, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit, znj. Irida Kacerja. Deri ditën e verifikimit janë zhvilluar 17 seanca gjyqësore, nga të cilat asnjëra nuk është shtyrë si pasojë e veprimeve të pajustificuara të gjykatës.

⁷¹ Bazuar në nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile (me ndryshimet në atë kohë), përcaktohet se: “[...]Procesverbali duhet të tregojë personat që marrin pjesë në veprimet për të cilat mbahet akti, rrethanat e vendit e të kohës në të cilat mbahet akti, përshkrimi i veprimtarisë së kryer dhe i fakteve të rezultuara, si dhe deklaratat e bëra...[...]”.

i) Lidhur më konstatimin e parë – sipas subjektit fletëthirrja është e rregullt, mban datën e përpilimit të saj, si dhe datën dhe orën kur pala duhet të paraqitet në seancë. Nga sekretarja, për shkak të shpejtësisë dhe për shkak se procesverbali në atë kohë mbahej me shkrim dhe jo përmes regjistrimit audio, nuk është pasqyruar vetëm data e përpilimit të fletëthirrjes, pra përbën thjesht një gabim material të sekretares gjyqësore. Data dhe ora e gjykimit është përcaktuar në procesverbal dhe shtyrja e çdo seance është e motivuar dhe përmban bazë ligjore. Në lidhje me prezencën e palëve në seancën gjyqësore të datës 11.2.2011, deklaroi se është pranuar si objektiv shkaku i mosprezencës së përfaqësuesit të paditësve dhe njëkohësisht është disponuar edhe me marrjen e provave, duke mos cenuar të drejtat e asnjërës prej palëve⁷²

ii) Për sa i takon konstatimit të dytë, subjekti shprehet se këto procesverbale ndodhen në dosje dhe është detyra e sekretares gjyqësore t'i hedhë ato në sistem.

iii) Lidhur me konstatimin e zvarritjes së procesit gjyqësor, subjekti deklaroi se gjykimi i çështjes ka qenë i pezulluar mbi bazën e kërkesës së të paditurit A. K. për shkak të një procesi penal dhe në vijim seancat gjyqësore janë shtyrë për shkak të mosmarrjes dijeni të përfaqësuesit të palës së paditur. Rezulton se gjykimi ka qenë kompleks, pasi kundërshtoj një vendim i ish-KKK Pronave, pra mes palëve kishte mosmarrëveshje pronësie dhe lindte nevoja e zhvillimit të shumë seancave gjyqësore dhe marrjes së shumë provave, ndër to, dhe prova me ekspert. Gjithashtu, nga pala e paditur në datën 11.2.2011 është paraqitur edhe një kundërpadi. Afati i gjykimit nuk mund të merret i shkëputur nga analiza e çështjeve konkrete dhe specifikat e tij, nga volumi i provave të nënshtruara debatit gjyqësor, si dhe veprimeve procedurale të kryera nga gjykata, pretendimeve të palëve, numrit të palëve që marrin pjesë në gjykim dhe kohës që nevojitet për njoftimin e palëve etj. Nga analiza e procesverbaleve të seancave gjyqësore të kësaj çështjeje, rezulton se seancat kanë qenë përherë produktive dhe shtyrjet e tyre përherë të motivuara për shkaqe objektive. Për sa i takon afatit 6-mujor, të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në vetë këtë aneks thuhet se ai është orientues dhe jo detyrues dhe vlerësimi ndryshon në raport me specifikat e çështjes konkrete. Gjykata, bazuar në nenin 14 të Kodit të Procedurës Civile, ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin, prandaj nuk është në interesin e palëve, që procesi të përfundojë pa marrë provat e nevojshme dhe pa kryer veprimet e nevojshme procedurale, siç dhe ka ndodhur në këtë rast.

Analiza e Komisionit – pasi u analizuan provat e paraqitura⁷³ lidhur me konkluzionin se nuk është pasqyruar data e përpilimit të fletëthirrjes, subjekti shpjegoi bindshëm se përbën thjesht një gabim material të sekretares gjyqësore. Data dhe ora e gjykimit është përcaktuar në procesverbal dhe shtyrja e çdo seance është e motivuar. Lidhur me pretendimet e subjektit se procesi gjyqësor është zvarritur si rezultat i kërkesave të denoncuesit A. K. për pezullimin e gjykimit dhe mosparaqitjen e adresës së saktë, Komisioni evidenton se nga analizimi i fashikullit gjyqësor, qëndrojnë shpjegimet e subjektit, pasi: në seancën e datës 25.3.2011 është vendosur pezullimi i gjykimit deri në përfundim të gjykimit penal (mbi bazën e kërkesës së të paditurit A. K. për shkak të një procesi penal). Gjykimi ka rifilluar në datën 21.6.2011, në këtë

⁷² Në procesverbal relatohet prezenca e palëve dhe konstatohet se avokati që është edhe përfaqësuesi i paditësve ndodhet në një rast vdekjeje, por ndërkohë nga ana e palës së paditur ka një kërkesë për disponimin me vendim për marrjen e disa provave të të tretët, prandaj gjykata për ekonomi gjyqësore dhe për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm shtyn seancën për të bërë të mundur praninë e përfaqësuesit të paditësve dhe njëkohësisht për të pasur një seancë gjyqësore produktive disponon dhe mbi marrjen e provave të nevojshme, bazuar në nenet 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë rast nuk konstatohet asnjë shkelje të kryer nga ana ime, për sa i takon prezencës së palëve.

⁷³ Deklaratë e thjeshtë (jo noteriale) datë 26.2.2021, lëshuar nga shtetasi F. Ç., kopje e kartës së identitetit nr. ***, nr. personal ***, fashikulli nr. ***, nr. them. ***, datë regj. 6.2.2010, nr. *** vendimi, datë 12.4.2010; fashikulli nr. ***, nr. them. ***, datë regj. 15.10.2010, nr. *** vendimi, datë 11.10.2012.

seancë dhe në ato të datave 21.6.2011, 12.7.2011, 21.9.2011, 10.10.2011, sipas procesverbaleve gjyqësore rezulton se pala e paditur A. K. nuk ka dijeni për seancën, pasi rezulton adresë e gabuar. Në seancën e datës 14.11.2011 nuk është paraqitur i padituri A. K. dhe përfaqësuesi i tij av. G. M. rezulton me raport mjekësor. Në seancën e datës 31.1.2012, përsëri nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur (ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e seancës me motivacionin se ndodhet në një gjykim tjetër).

Lidhur me kohëzgjatjen e këtij gjykimi vlen të theksohet se çështja paraqitet komplekse. Gjithashtu rezultoi se denoncuesi A. K. është ankuar pranë ish-KLD-së për zvarritje të procesit gjyqësor dhe rezulton se pikërisht ky shtetas ka kërkuar shtyrjen e disa seancave gjyqësore.

Lidhur me pretendimet e subjektit se procesverbalet e 9 seancave nga data 25.3.2011 deri më 27.12.2011, ndodhen në dosjen gjyqësore dhe se nuk është detyra e saj për hedhjen e tyre në sistem, Komisioni konstaton se referuar dokumentit *print screen* të administruar nga KLD-ja dhe procesverbalit (të mbajtur nga IT-ja e gjykatës dhe personat e tjerë prezent), sipas të dhënave të usb-së së sekretares gjyqësore në çështjen civile me palë A. K., rezulton se materialet janë krijuar në datën 10.10.2011 dhe janë modifikuar në datën 4.1.2012, ora 10:23:18, datë në të cilën është paraqitur për inspektim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër inspektori A. Q. Pra, sipas materialit të analizuar në dosjen e inspektimit, rezulton të jetë ndërhyrë ditën e inspektimit nga KLD-ja.

Sa më sipër rezultoi, Komisioni çmon se kjo çështje duhet të transferohet në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ose nëse ka shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit.

4. Ankesa e shtetasit A. L.

Pas analizimit të dosjes së inspektimit, Komisioni vëren se ky shtetas ankohet për zvarritje të gjyqësorit nga subjekti i rivlerësimit. Rezultoi se gjykimi ka përfunduar për pothuajse 1 vit e 5 muaj dhe deri në momentin e verifikimit janë zhvilluar 4 seanca përgatitore dhe 18 seanca gjyqësore, nga të cilat asnjëra nuk është shtyrë si pasojë e veprimeve të pajustificuara të gjykatës. Në përfundim, KLD-ja ka urdhëruar arkivimin e kësaj ankese, pasi vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje të ligjit që të përbënin shkelje discipline në kuptim të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", nuk ka vend për verifikim të mëtejshëm disiplinor ndaj subjektit, por kjo çështje duhet evidentuar për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale, pasi nuk është organizuar mirë puna (nuk janë marrë masa ndaj ekspertit).

Nga hetimi i Komisionit rezultoi se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë masa ndaj ekspertit gjatë shqyrtimit të çështjes, gjë që ka sjellë shtyrjen e 9 seancave gjyqësore; (ii) konstatohet se ka zvarritje të procesit gjyqësor, pasi gjykimi ka zgjatur gjithsej 1 vit e 5 muaj deri në momentin e verifikimit, jashtë afatit të caktuar në Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit, duke sjellë për pasojë cenimin e të drejtave të palëve në proces. Subjekti iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime dhe prova për konstatimin e Komisionit.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se në lidhje me mosmarrjen e masave ndaj ekspertit gjatë shqyrtimit të çështjes, subjekti deklaroi se janë shtyrë 4 seanca gjyqësore pa shkaqe të justifikuara dhe jo 9 të tilla. Subjekti sqaroi se nuk janë marrë masa ndaj ekspertit, pasi mungesat e tij nuk kanë qenë të njëpasnjëshme por të shpëputura nga njëra-tjetra. Çështja paraqitet komplekse dhe për këtë arsye ka qenë e nevojshme që të kryhen detyra shtesë, si dhe të ribëhet aktekspertimi për shkak të

pretendimeve të reja të palëve, prandaj edhe mungesat e ekspertit mund të kenë ndodhur për këtë shkak, si dhe për shkak se ekspertët ishin të ngarkuar me kryerjen e shumë akteksptimeve edhe të gjyqtarëve të tjerë. Mungesat e ekspertit nuk kanë ndodhur për shkaqe që varen prej subjektit dhe nuk ka një zvarritje të qëllimshme të gjykimit.

Në lidhje me konstatimin se ka zvarritje të procesit gjyqësor, subjekti deklaroi se ky gjykim ka qenë kompleks, pasi mes palëve kishte mosmarrëveshje pronësie dhe lindte nevoja e zhvillimit të shumë seancave gjyqësore dhe shtimit të palëve të treta. Për shkak të pretendimeve të shumta dhe të reja të palëve, ka lindur nevoja që të kryhen detyra shtesë si dhe të ribëhet akteksptimi. Afati i gjykimit nuk mund të merret i shkëputur nga analiza e çështjeve konkrete dhe specifikat e tij, nga volumi i provave të nënshtruara debatit gjyqësor, si dhe veprimeve procedurale të kryera nga gjykata, pretendimeve të palëve, numrit të palëve që marrin pjesë në gjykim dhe kohës që nevojitet për njoftimin e palëve etj. Në lidhje me ankimin e këtij shtetasi, subjekti paraqiti në cilësinë e provës kopjet e vendimeve të tri shkallëve, ku rezultoi se prej saj është realizuar një hetim i plotë dhe i gjithanshëm dhe vendimi është lënë në fuqi. Gjykimi, në të dyja shkallët e tjera, ka zgjatur në një afat të konsiderueshëm, megjithëse secila prej këtyre gjykatave asistohet nga staf mbështetës (këshilltarë/ndihmësligjorë).

Pasi u analizuan provat e paraqitura⁷⁴, Komisioni çmon se kjo çështje duhet të transferohet në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ose nëse ka shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 18.11.2020, i një grupi gjyqtarësh magjistratë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër**

Sipas pretendimeve të ngritura, subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, akuzohet për sjellje joetike dhe se ka arritur të manipulojë e të përdorë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor duke kandiduar vetëm për të kaluar shpejt dhe lehtë procesin e rivlerësimit kalimtar. Denoncuesit deklarojnë se rezultoi një procedim disiplinor i nisur nga KLD-ja si rezultat i ankesave të disa qytetarëve dhe se subjekti paraqet shpesh raporte mjekësore dhe shmang gjykimin e çështjeve problematike. Gjatë kohës që ka qenë ndihmësligjorë në Gjykatën e Lartë ka përdorur këtë pozicion për t'i ofruar punë bashkëshortit të saj. Me anë të këtij denoncimi është kërkuar riçelja e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit dhe ndërprerja e procedurës së rivlerësimit të saj nga Komisioni si kandidate për në Gjykatën e Posaçme të Apelit duke e trajtuar jo më me përparësi në procesin e rivlerësimit.

Nga hetimi i Komisionit rezultoi se Këshilli i Lartë Gjyqësor, në datën 5.11.2020, ka zhvilluar mbledhjen plenare të radhës, ku ndër të tjera ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për kandidaten Irida Kacerja, për shkak të tërheqjes së saj nga gara.

Gjatë hetimit administrativ kryesisht, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁷⁵ dhe ka kërkuar informacion nëse subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, rezultoi të ketë kryer procese gjyqësore në të cilat shtetasi M.B., bashkëshorti, figuron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të palëve ndërgjyqëse. Në përgjigje⁷⁶, gjykata bën me dije se sistemi

⁷⁴ Fashikulli i dosjes nr. regj. *** , datë regj. 30.4.2010, nr. vendimi *** , datë 26.9.2011; vendimin nr. *** , datë 26.9.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vendim nr. *** , datë 24.2.2014, i Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, vendimi nr. *** , datë 21.12.2016, i Gjykatës së Lartë Tiranë (Kolegji Administrativ).

⁷⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2020.

⁷⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2020.

ICMISS dhe regjistri fizik nuk ofrojnë mundësi gjenerimi të të dhënave mbi përfaqësuesit ligjorë të palëve në gjykim. Kjo e dhënë mund të përftohet vetëm nga kontrolli fizik i dosjeve gjyqësore, që në rastin e subjektit të rivlerësimit prej periudhës 5.10.2007 – 15.11.2012, si dhe nga data 15.11.2015 e në vijim ka shqyrtuar rreth 3817 çështje.

Më tej, referuar *indicieve* në denoncimet e paraqitura, Komisioni i është drejtuar përsëri Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁷⁷ dhe ka kërkuar të kryhet kontrolli fizik i dosjeve gjyqësore për të verifikuar nëse subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka kryer procese gjyqësore në të cilat av. M.B. figuron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të palëve ndërgjyqëse.

Në përgjigje⁷⁸, gjykata informon se nga verifikimet e realizuara nuk rezultoi që av. M.M.B. të ketë qenë avokat apo përfaqësues ligjor në gjykimet e gjyqtares Irida Kacerja. Në rastet kur av. M.B. ka qenë përfaqësues i palëve ndërgjyqëse për çështjet e shortuara pranë gjyqtares Irida Kacerja, kjo e fundit ka paraqitur kërkesat për dorëheqje pranë kryetarit të gjykatës.

Gjatë kontrollit të ushtruar nga Komisioni në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë⁷⁹ për të gjitha vendimet e periudhës 15.11.2012 – 13.11.2015, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit është emëruar ndihmësligjore pranë kësaj gjykate, rezultoi se av. M.B. nuk ka qenë përfaqësues ligjor i palëve ndërgjyqëse në asnjë prej çështjeve të gjykuara gjatë kësaj periudhe.

Referuar pretendimeve në denoncim mbi mungesat e shpeshta në punë dhe shmangiet nga gjykimet e çështjeve problematike, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për sa vijon: (i) të gjitha rastet nga të cilat ka dhënë dorëheqjen nga çështjet gjyqësore, motivacioni i paraqitur dhe vendimet përkatëse për pranimin ose jo të dorëheqjes; (ii) numrin e çështjeve nga të cilat ka dhënë dorëheqjen, në rastet kur bashkëshorti i saj ka qenë përfaqësues i palëve ndërgjyqëse; (iii) për të gjitha rastet kur ka munguar në punë duke paraqitur si motivacion shkaqet shëndetësore, të vëre në dispozicion dokumentacion provues (raport mjekësor).

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se ky denoncim është abuziv dhe pretendohen fakte të pavërteta. Deklaron se ka paraqitur kandidaturën për vendin vakant në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe ka hequr dorë për shkak se sipas ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë të drejtën të paraqesin vetëm 3 kërkesa për 3 vende vakante. Më tej, ka paraqitur menjëherë kërkesën e tretë, në vendin vakant të shpallur me vendim të KLGj-së në Gjykatën e Apelit Tiranë, e drejta civile, aplikim ky që kishte afat përfundimtar datën 23.10.2020. Në lidhje me pretendimin se paraqet shpesh raporte mjekësore, subjekti, referuar shkresës së lëshuar nga kryetari i degës së buxhetit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezultoi se janë shumë të pakta (8 të tilla) dhe përmbajnë pushim nga 2 deri në 3 ditë. Subjekti shprehet se asnjëherë nuk ka abuzuar me një gjë të tillë dhe nuk ka neglizhuar kryerjen e detyrave si gjyqtare. Për sa i takon pretendimit se shmang gjykimin e çështjeve problematike dhe jep shpesh dorëheqje, subjekti deklaroi se nuk ka qenë asnjëherë në qëllimet dhe metodën e saj të punës, por përkundrazi ka zgjidhur shumë çështje problematike që kishin vite që gjykoheshin nga gjyqtarë të tjerë, të cilët hiqnin dorë nga gjykimi. Për sa i takon pretendimit që ka shfrytëzuar postin si ndihmësligjore pranë Gjykatës së Lartë për t’i siguruar punë bashkëshortit të saj, subjekti shprehet se është një pretendim abuziv.

⁷⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.11.2020.

⁷⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020.

⁷⁹ [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Vendime te Gjykatës se Lartë nga viti 1999 387 1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Vendime%20te%20Gjykat%20se%20Larte%20nga%20viti%201999%20387%201.php)

Analiza e Komisionit, pasi u analizuan provat e paraqitura⁸⁰, rezultoi sa vijon:

i) Referuar raporteve të paraqitura prej periudhës nëntor 2015, figurojnë 8 raporte mjekësore, çka tregon se subjekti nuk ka abuzuar me prezencën e saj në ushtrimin e detyrës si magjistrate.

ii) Pasi u shqyrtuan të gjitha rastet e dorëheqjeve dhe motivacioneve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, evidentohet se në 4 raste subjekti ka dhënë dorëheqjen si rezultat i përfaqësimit të palëve në gjykim nga bashkëshorti i saj në cilësinë e avokatit mbrojtës (në datat 7.2.2012; 8.11.2017; 10.4.2018; 27.2.2020).

Lidhur me kërkesat e tjera rezultoi se: (i) në datën 17.1.2017, subjektit i është tërhequr vëmendja pasi ka paraqitur kërkesë për dorëheqje me motivacionin “Si rregull i përgjithshëm për çështjet e pushuara, shorti duhet t’i caktohet të njëjtit gjyqtar që ka vendosur pushimin.” Kërkesa nuk është pranuar nga kryetari i gjykatës, pasi kjo gjë nuk ishte evidentuar më parë dhe paraqitej 4 muaj pasi çështja ishte regjistruar. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me kërkesat e datave 4.10.2017 dhe 11.12.2017, kërkesa të paraqitura respektivisht 2 dhe 1 muaj e gjysmë pasi çështja ishte regjistruar; (ii) në datën 12.7.2018, subjekti ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga gjykimi me motivacionin: “Motra e saj ka marrë me qira *online* një banesë pushimi në Velipojë, në pronësi të z. A. B. palë në proces. Duke qenë se ka ndërmend t’i bëjë pushimet me motrën, mendon se ka shkak për të kërkuar dorëheqjen”. Kjo kërkesë nuk është pranuar dhe çështja është shortuar në datën 12.4.2018 dhe deri në datën 10.5.2018 nuk ishte kryer asnjë veprim, por në këtë datë (10.5.2018) subjekti ka kthyer padinë për të meta, pasi nuk ka kopje aktesh për avokaturën e shtetit. Kryetari i gjykatës shprehet në vendim se nëse ka një prenotim *online* që cenon figurën e gjyqtarit në punën e tij, duhet të anulohet menjëherë dhe subjekti nuk është i justifikuar të mënjanojë ushtrimin e detyrës në funksion të interesit privat; (iii) në datën 12.7.2018, subjekti ka paraqitur kërkesë për dorëheqje me arsyetimin se xhaxhai i saj është debitor në shoqërinë “A.” sh.a., debi e përfshirë në objektin e padisë. Kjo kërkesë është pranuar, por subjektit i është tërhequr vëmendje për afatet e gjykimit dhe të dorëheqjes; (iv) Komisioni evidenton se subjekti ka paraqitur edhe 29 dorëheqje të tjera me motivacione të ndryshme, të cilat nuk janë pranuar. Ndër to evidentohet edhe fakti se subjekti ka paraqitur dorëheqjen nga çështjet në të cilat shtetasi G. Y. figuronte në cilësinë e avokatit mbrojtës të palëve me motivacionin se subjekti ishte në cilësinë e palës së paditur në procesin gjyqësor me paditës këtë shtetas. Këto kërkesa janë pranuar nga kryetari i gjykatës së asaj kohe, z. A. Z., por nuk janë pranuar më tej nga zëvendëskryetari A. Ç. me motivacionin se shtetasi G. Y. kishte paditur disa gjyqtarë të kësaj gjykate dhe kjo gjë nuk mund të përbënte shkak për dorëheqjen e tyre, pasi duke u dorëhequr të gjithë gjyqtarët e paditur mund të paragykohej dhe të paracaktohej edhe fakti se kujt i shortoheshin çështjet gjyqësore.

Në përfundim, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerëson se subjekti shpjegoi bindshëm faktet e konstatuara dhe në analizë të dokumentacionit provues ligjor të paraqitur në cilësinë e provës në prapësime, rezulton se denoncimi i paraqitur nuk përmban

⁸⁰ Njoftim i KLGj-së për mbledhjen plenare të datës 2.7.2020; njoftim datë 22.6.2020, i KLGj-së në lidhje me kandidaturat e paraqitura në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit; vendim nr. ***, datë 7.10.2020, i KLGj-së për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidaturë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile; njoftim datë 29.10.2020, i KLGj-së në lidhje me kandidaturat e paraqitura në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit, kërkesat për dorëheqje /shkresë kthim përgjigje e datës 1.3.2021 e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, relacion i datës 25.2.2021, raportet mjekësore, shkresa datës 26.2.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 26.11.2020, i shtetasit Z. M.**

Denoncuesi akuzon subjektin e rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, për veprime korruptive dhe sjellje joetike. Sipas pretendimeve të ngritura në këtë denoncim, në vitin 2017 një grup shoqëror të rinjsh në Shkodër, ku bënte pjesë edhe vajza e denoncuesit, u ndaluan nga policia për përdorim të lëndëve narkotike. Denoncuesi pretendon se bashkëshorti i subjektit, z. M.B., ka kontaktuar me avokatin e vajzës së tij dhe avokatët e tjerë të palëve, duke u kërkuar një shumë prej 2.000.000 lekësh në mënyrë që ndaj të akuzuarve të jepej masa e sigurimit “arrest në shtëpi”. Për rrjedhojë, prindërit e të pandehurve janë detyruar të mbledhin nga 500.000 lekë secili dhe pas kësaj subjekti i rivlerësimit ka vendosur lirim të tyre.

Duke qenë se denoncuesi nuk ka paraqitur asnjë provë lidhur me akuzat e ngritura për korrupsion ndaj subjektit të rivlerësimit në bashkëpunim me bashkëshortin e saj, Komisioni është përpjekur të kontaktojë me shtetasin Z. M.⁸¹ dhe ta ftojë të paraqitet për të dhënë më shumë shpjegime lidhur me deklaratimet e tij, por me shkresën nr. ***, datë 17.1.2021, të Komisarariatit të Policisë Shkodër është informuar se ky shtetas ka ndërruar jetë në datën 21.4.2018.

Për të hetuar më tej në lidhje me këtë çështje gjyqësore, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁸². Pas administrimit të materialeve gjyqësore⁸³ rezultoi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në datën 8.11.2017, ka bërë kërkesë për vlefësim të arrestit në flagrancë dhe ndalimit, si dhe caktim mase sigurimi “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale për shtetasit A. P., D. Sh., L. P., R. M., P. K. dhe A. L., të dyshuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike” kryer në bashkëpunim. Çështja në gjykatë është regjistruar në datën 8.11.2017 dhe i ka kaluar subjektin të rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, e cila ka caktuar seancën gjyqësore në datën 9.11.2017. Me vendimin nr. ***, datë 9.11.2017, ka vendosur: “Të vlefësoj të ligjshëm arrestin në flagrancë ndaj të pandehurve për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Të caktoj masën e sigurisë ‘arrest në shtëpi’ me mbikëqyrje elektronike për shtetasit D. Sh., R. M. dhe A. P.. Të caktoj masën e sigurisë ‘detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore’ për shtetasit P. K., L. P. dhe A. L.”

Në arsyetimin e saj, subjekti është shprehur se lidhur me të pandehurin D. Sh., vepra penale për të cilën akuzohet i dyshuari është një veprë që parashikon një sanksion deri në 15 vjet burg me një rrezikshmëri të lartë shoqërore. Në gjykim nuk është arritur të provohet se ai ka tentuar të largohet apo të bëjë përpjekje për fshehje të provave, madje ka ndihmuar organin e akuzës për zbardhjen e ngjarjes, duke treguar se lëndën narkotike e mban për qëllim përdorimi personal, pasi konsumon heroinë prej shumë vitesh. Sipas gjykatës, rëndësi të veçantë në zgjidhjen e masës së sigurisë ka edhe mosha e të pandehurit (34 vjeç, beqar, me arsim 8-vjeçar) dhe gjendja shëndetësore e tij. Gjykata çmon marrjen e një mase jo ekstreme siç është ajo e arrestit me burg, duke qenë se është person toksikoman dhe shpesh herë ka edhe probleme shëndetësore. Më tej, gjykata arsyeton se ndaj të dyshuarit është marrë kampion urine me qëllim përcaktimin nëse është përdorues i lëndëve narkotike dhe, sipas kuptimit të nenit 230/3 të Kodit të Procedurës Penale, ndaj një personi që dyshohet se është toksikoman nuk mund të

⁸¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.12.2020.

⁸² Shkresë nr. ***, datë 1.12.2020.

⁸³ Shkresë nr. ***, datë 3.12.2020.

caktohet masa e arrestit me burg⁸⁴. Të gjitha rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe ato personale të të dyshuarit duhen marrë parasysh në caktimin e masës së sigurisë, prandaj gjykata çmon se masa më e përshtatshme është “arrest në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike⁸⁵.

Në përfundim, Komisioni vëren se vepra penale për të cilën akuzohen të pandehurit dënohet me burgim 7-15 vjet⁸⁶. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Vlerësohet gjithashtu edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.

Për të dalë në një konkluzion më të saktë lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim dhe me gjykimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me veprat penale të parashikuara nga neni 283 i Kodit Penal “prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, Komisioni kërkoi informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁸⁷, nga ku rezultoi se subjekti Irida Kacerja ka dhënë 48 vendime “Caktim masë sigurie” për veprat penale të parashikuara nga neni 283 i Kodit Penal. Komisioni shqyrtoi të gjitha vendimet e dhëna për të analizuar qëndrimin e mbajtur nga subjekti në rastet e ngjashme me atë të denoncimit nr. *** prot., datë 26.11.2020, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit, kriteri i aftësive profesionale të gjyqtarit vlerësohet bazuar në aspektet e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, por pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Sa më sipër, rezultoi se në 3 vendime⁸⁸, subjekti, pasi ka vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë ka caktuar masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, edhe pse nga Prokuroria ishte kërkuar caktimi i masës “arrest me burg”. Në këto gjykime është pretenduar se të dyshuarit për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike” kanë qenë përdorues (toksikoman), për këtë arsye, ndaj tyre në disa raste, është marrë kampion urine me qëllim përcaktimin nëse janë apo jo përdorues të lëndëve narkotike. Ndërkohë që referuar vendimit nr. ***, datë 18.6.2018 (pak a shumë të njëjtat rrethana) subjekti ka vendosur caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, duke qenë se i dyshuari rezultonte përsëritës i të njëjtës vepër penale edhe në tri raste të tjera. Në 4 vendime (nr. ***, datë 15.5.2018; nr. ***, datë 29.1.2017⁸⁹; nr. ***, datë 16.6.2012 dhe nr. ***, datë 28.4.2009) subjekti ka caktuar masën e sigurimit të kërkuar nga Prokuroria, “arrest me burg”, për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike” edhe pse të dyshuarit kanë pretenduar se kanë qenë përdorues (toksikoman).

⁸⁴ Neni 230 i Kodit të Procedurës Penale, ku në pikat 2 dhe 3 përcaktohet se: “Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë nën moshën 3 vjeç dhe që jeton me të, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën 70 vjeç ose një personi toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm. Në rastet e parashikuara në pikën 2, arresti në burg mund të vendoset vetëm kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se 10 vjet burgim”.

⁸⁵ Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, por në dosje administrohet kërkesa e datës 27.11.2017, për heqje dorë nga ankimi, e paraqitur nga prokurori A. D. Referuar vendimit nr. ***, datë 24.11.2017, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur mospranimin e ankimit të bërë ndaj vendimit të shkallës së parë, si rezultat i heqjes dorë nga ankimi gjatë gjykit.

⁸⁶ Referuar dispozitave të nenit 283 të Kodit Penal, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga 5 deri në 10 vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga 7 deri në 15 vjet.

⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.1.2021.

⁸⁸ Vendimet nr. ***, datë 4.8.2017; nr. ***, datë 4.8.2017; dhe nr. ***, datë 2.11.2016.

⁸⁹ Vlen të përmendet se në këtë rast sasia e lëndëve narkotike të dyshuara si kanabis sativa është në masën 10 kg dhe 356.8 gr.

Në prapësime, subjekti deklaroi se sikundër ka konstatuar edhe Komisioni, nuk është mohuar fakti që i pandehuri D. SH. dyshohej për kryerjen e kësaj vepre penale, por për shkak të rrethanave të veçanta, që kanë të bëjnë me shëndetin e tij, është disponuar me masën e sigurimit “arrest në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike, e cila duhet thënë që është gjithashtu një masë e rëndë. Ai person, në seancën e vleftësimit të arrestit, u paraqit në gjendje shëndetësore të tillë që nuk rrinte dot në këmbë, ishte i zbehtë dhe në krahët e tij ishte i nxirë. Siç rezulton edhe nga vendimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka ushtruar ankim dhe prokurori pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka hequr dorë nga ankimi. Pra, edhe organi i akuzës, në një shkallë më të lartë të gjyqësorit, pasi është njohur me nivelin e provueshmërisë së provave të marra gjatë hetimeve, ka krijuar bindjen se secila prej masave të sigurimit është në përputhje me nevojat e sigurimit.

Bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson. Në këto kushte, Komisioni çmon se kjo çështje duhet të transferohet në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ose nëse ka shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit.

7. Hetime të tjera

Bazuar në çështjet e sipërtrajtuara dhe në *indiciet* e marra prej tyre, Komisioni kërkoi informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁹⁰ lidhur me: (i) listën e të gjitha vendimeve gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil nga subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, për të gjithë periudhën që ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në këtë gjykatë; (ii) ngarkesën në punë të gjyqtarës Irida Kacerja për të gjithë periudhën që ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në këtë gjykatë.

Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 28.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër evidentohet se⁹¹: për vitin 2008⁹² janë konstatuar 56 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 26 % vonesa në zbardhjen e vendimeve; për vitin 2009⁹³ janë konstatuar 113 vendime që përbëjnë rreth 43 % vonesa; për vitin 2010⁹⁴ janë konstatuar 44 vendime që përbëjnë rreth 16 % vonesa; për vitin 2011⁹⁵ janë konstatuar 50 vendime që përbëjnë rreth 11 % vonesa; për vitin 2012⁹⁶ janë konstatuar 277 vendime që përbëjnë rreth 48 % vonesa; për vitin 2015 nuk janë konstatuar vonesa; për vitin 2016⁹⁷ janë konstatuar 6 vendime që përbëjnë rreth 1 % vonesa; për vitin 2017⁹⁸ janë konstatuar 8 vendimeve që përbëjnë rreth 1 % vonesa; për vitin 2018⁹⁹ janë konstatuar 28 vendimeve që përbëjnë rreth 6 % vonesa; për vitin 2019¹⁰⁰ janë konstatuar 41

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 20.1.2021.

⁹¹ Referojuni Aneksit B.

⁹² Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 213 çështje (civile 171, kërkesa civile penale 42).

⁹³ Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 264 çështje (civile 210, penale 54).

⁹⁴ Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 276 çështje (civile 193, penale 83).

⁹⁵ Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 456 çështje (civile 358, penale 98).

⁹⁶ Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 571 çështje (civile 507, penale 64).

⁹⁷ Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 390 çështje (civile 261, penale 129).

⁹⁸ Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 532 çështje (civile 427, penale 105).

⁹⁹ Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 453 çështje (civile 311, penale 142).

¹⁰⁰ Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 483 çështje (civile 363, penale 120).

vendime që përbëjnë rreth 8 % vonesa; për vitin 2020¹⁰¹ janë konstatuar 31 vendime që përbëjnë rreth 11 % vonesa.

Komisioni vlerëson se mosdorëzimi në kohë i dosjeve gjyqësore është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e subjektit të rivlerësimit dhe lidhet me efektivitetin e ankimit, shkaqet e ankimit, shtyrjen e afatit të gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, si dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rregullshmërinë e procesit gjyqësor¹⁰². Arsyetimi në kohë i vendimit nga gjyqtari është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe sidomos i parimit kushtetues të “gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm kohor”. Mungesa e arsyesimit dhe dorëzimit të vendimit brenda afatit kohor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile pengon palët të gëzojnë ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit, si pjesë e procesit të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.¹⁰³

Lidhur me sa u konstatua nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për sa vijon:

(i) subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar afatet e parashikuara nga legjislacioni procedural civil mbi dorëzimin e vendimeve gjyqësore dhe kohën mesatare dedikuar çështjeve që ka pasur në shqyrtim, çka sjell mungesë të aftësive për të përballuar ngarkesën në punë; (ii) për sa rezulton të paraqitet lista e të gjitha gjykimeve të kryera për periudhën që ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku të evidentohen datat e regjistrimit të çështjeve dhe datat e përfundimit të gjykimeve.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi: Në lidhje me vonesën në zbardhjen e vendimeve gjyqësore: (i) sikundër është konstatuar, shumica e dosjeve janë dorëzuar në sekretari brenda afatit të ankimit dhe afati 10-ditor, të cilit i referohet sekretaria gjyqësore ka qenë orientues nga KLD-ja; (ii) pjesa dërrmuese e dosjeve janë urdhra ekzekutimi, ku kërkesat janë pranuar dhe pala nuk ka të drejtë ankimi; (iii) një numër i konsiderueshëm i tyre janë kërkesa për lejim përgjimi, të cilat për arsye të sekretit hetimor dhe të disponimit të gjykatës për mosdepozitimin e tyre në sekretari, janë mbajtur të padorëzuara; (iv) numri i çështjeve të gjykuara është i lartë dhe çështjet janë komplekse; (v) në statistikat e nxjerra nuk është marrë parasysh periudha e pushimeve, muaji gusht, pasi një pjesë e madhe e vendimeve janë shpallur në korrik dhe në pushimet e fundvitit, periudhë gjatë së cilës sekretaria e gjykatës reregjistron të gjitha çështjet.

Analiza e Komisionit – pasi u analizuan të gjitha gjykimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër (ku u evidentuan datat e regjistrimit të çështjeve dhe datat e përfundimit të gjykimeve)¹⁰⁴ në raport kjo me ngarkesën e në punë të subjektit (statistika të evidentuara gjatë analizës së vendimeve gjyqësore), rezultoi sa vijon: për vitin 2008 janë konstatuar 7 procese gjyqësore të zhvilluara në tejkalim të afateve të parashikuara, që përbëjnë rreth 3 % vonesa në gjykime; për vitin 2009

¹⁰¹ Ngarkesa në punë e subjektit ka qenë 280 çështje (civile 198, penale 82).

¹⁰² Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon parimin: “Kushdo ka të drejtë të ankohe kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Neni 310, paragrafi 3, pika 3, e Kodit të Procedurës Civile parashikon se pjesa urdhëruese e vendimit duhet të përmbajë të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij. Neni 443, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: “Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë”.

¹⁰³ Për pasojë, mosdorëzimi i vendimeve të arsyetuara nga subjekti i rivlerësimit ka kapërcyer afatet ligjore të ankimit të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 443, të Kodit të Procedurës Civile. Këto vonesa kushtëzojnë palët në përgatitjen e ankimit duke sjellë pengesa për ushtrimin efektivisht të së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë për sa kohë që nuk kanë akses në arsyetimin e vendimit të gjykatës dhe, për pasojë, kufizimin e mundësisë për të ngritur argumente kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

¹⁰⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 25.2.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër bashkë me të dhëna statistikore, përkatësisht: materialet I-XII, informacion mbi çështjet civile dhe penale, të ndara sipas viteve kalendarike 2007 – 2012 dhe 2015 – 2020, sipas sistemit ARK-IT dhe ICMIS të menaxhimit të çështjeve.

janë konstatuar 9 procese gjyqësore, që përbëjnë rreth 3 % vonesa në gjykime; për vitin 2010 janë konstatuar 24 procese gjyqësore, që përbëjnë rreth 9 % vonesa në gjykime; për vitin 2011 janë konstatuar 60 procese gjyqësore, që përbëjnë rreth 13 % vonesa në gjykime; për vitin 2012 janë konstatuar 231 procese gjyqësore, që përbëjnë rreth 40 % vonesa në gjykime; për vitin 2015 janë konstatuar 5 procese gjyqësore, që përbëjnë rreth 26 % vonesa në gjykime; për vitin 2016 janë konstatuar 109 procese gjyqësore, që përbëjnë rreth 28 % vonesa në gjykime; për vitin 2017 janë konstatuar 99 procese gjyqësore, që përbëjnë rreth 18 % vonesa në gjykime; për vitin 2018 janë konstatuar 54 procese gjyqësore, që përbëjnë rreth 12 % vonesa në gjykime; për vitin 2019 janë konstatuar 115 procese gjyqësore, që përbëjnë rreth 24 % vonesa në gjykime.

Arsyetimi i subjektit se afati 10-ditor ka qenë orientues nga KLD-ja dhe se ky afat nuk është i përcaktuar në legjislacionin procedural civil nuk qëndron, pasi në referencë të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata kur shtyn shpalljen e vendimit ka detyrimin ligjor të respektojë afatin 5-ditor të shtyrjes, si dhe detyrimin e zbardhjes së vendimit brenda 10 ditëve, detyrime të cilat nuk janë zbatuar nga subjekti. Pra, neni 308 përcakton se: *“Në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në pesë ditë ...”*. Megjithatë, Komisioni, pasi analizoi listën e të gjitha gjykimeve të kryera konstaton se pjesa më e madhe e vonesave në gjykime dhe zbardhjen e vendimeve gjyqësore evidentohet në proceset gjyqësore me objekt “lëshimin e urdhrit të ekzekutimit”.

Komisioni, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit kriteri i aftësisë organizative të gjyqtarit vlerësohet duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe për të konkluduar mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, çmon se duhen evidentuar këta faktorë: (i) përqindja e dosjeve/gjykimeve të dorëzuara/zhvilluara me vonesë në raport me ato të dorëzuara/zhvilluara në kohë rezultojnë të jetë e ulët; (ii) këto vonesa kanë ardhur si rezultat i ngarkesës së lartë në punë; (iii) kompleksiteti i çështjeve, cilësia e vendimeve dhe vonesat administrative janë faktorë që mbahen në konsideratë; (iv) disa prej vendimeve konstatohet të jenë kërkesa për lejim përgjimi, të cilat për arsye të sekretit hetimor dhe të disponimit të gjykatës për mosdepozitimin e tyre në sekretari, janë mbajtur të padorëzuara.

Në raport me sa më sipër rezultojnë se në të gjitha çështjet e analizuara subjekti shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, si dhe zotëron njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, referuar nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni vlerëson se çështjet e transferuara në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, nuk janë të mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit si “me mangësi” apo “i papërshtatshëm” në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale në kuptim të germave “b” dhe “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

Si konkluzion, Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, është “e aftë” pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçente në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar kushtet në lidhje me tri kriteret e rivlerësimit për t’u konfirmuar në detyrë, Komisioni çmon se tri çështjet e analizuarra më sipër, (1) nr. ***, regjistruar më 30.4.2010; (2) nr. ***, regjistruar më 15.10.2010; (3) nr. ***, regjistruar më 8.11.2017, t’i transferohen organit kompetent për inspektim sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier dhe referuar gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Irida Kacerja, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë pranë organit kompetent për inspektim nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore ose shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij çështjen nr. ***, regjistruar në datën 30.4.2010; çështjen nr. ***, regjistruar në datën 15.10.2010 dhe çështjen nr. ***, regjistruar në datën 8.11.2017.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

4. Ndaj këtij vendimi, me përjashtim të pikës 2, mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ky vendim u shpall në datën 16.3.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Genta Tafa (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj